18 neve rivlerësuam kohën që keni propozuar për kundërpyetje,
19 megjithatë nuk është se ju pyeta në qoftë se keni rivlerësuar
20 kohën që ju duhet për të marrë në pyetje dëshmitarin e radhës.

21 A mund të na thoni tani në qoftë se është e mundur?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, po, e kemi
23 zbritur kohën që na duhet, e kemi shkurtuar nga katër në dy
24 orë, dy orë e gjysmë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përderisa unë do jem personi

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 54

1 kryesor që do bëj pyetje lidhur me atë person, ne vlerësojmë
2 që do të na duhet e njëjta kohë që kemi vlerësuar më përpara,
3 katër orë.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ne mendojmë që do na duhet tre orë
5 e gjysmë.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne do na duhet i njëjti
7 vlerësim që kemi dhënë dhe më përpara.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa orë, se
9 nuk më kujtohet?

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dy orë, i nderuar Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, ju
12 lutem sillni dëshmitarin në sallë.

13 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ndërkohë që presim që të
14 vijë dëshmitari, dëshiroj që t'ju tërheq vëmendjen lidhur me
15 një mesazh në postë elektronike që kam dërguar gjatë pushimit.
16 Do të doja t'ju informoja lidhur me këtë njoftim. Nuk është
17 diçka e cila ia vlen që të diskutohet tani, por thjesht kjo
18 është si kujtesë për të gjithë në mënyrë të tillë që ta
19 lexojnë dhe ta trajtojnë siç duhet.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
22 të vazhdojmë më tej. Z. Roberts që është në këmbë është
23 përfaqësuesi i Mbrojtjes së z. Selimi dhe ai e ka fjalën tani
24 për t'ju bërë pyetje.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 55

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve.

2 PY. Dhe përshëndetje, Dëshmitar.

3 PË. Përshëndetje.

4 PY. Unë kam pak pyetje për ju. Sigurisht nëse keni nevojë për
5 sqarime të mëtejshme për pyetjet që do t'ju bëj, mos hezitoni
6 që të m'i bëni kërkesat. A më dëgjoni mirë?

7 PË. Ju dëgjoj shumë mirë, faleminderit që më pyetët.

8 PY. Dua t'ju kujtoj që, ju lutem, prisni derisa ta përfundoj
9 pyetjen përpara se sa të përgjigjeni. Ne të dy po flasim të
10 njëjtën gjuhë, por megjithatë duhet të jemi të kujdesshëm për
11 ta ndihmuar stenografin sa më shumë të jetë e mundur.

12 Pyetja e parë ka të bëjë me sqarimet të mëtejshme sa i
13 takon hyrjes tuaj, ose mbërritjes tuaj në Prishtinë. Me sa më
14 kujtohet mua, ju jeni futur në Prishtinë më 12 gusht në 1998,
15 si drejtuesi i KDOM-it të Shteteve të Bashkuara, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Siç keni thënë në deklaratën e ZPS-së ju keni qenë oficer
18 politik në Beograd në vitin 1980 -- nga viti 1980 deri në
19 1984, dhe pastaj shkurtimisht në vitin 1992. A ka qenë hera e
20 fundit kjo përpara se sa të ktheheshit në Kosovë në 1998 që
21 keni punuar për Kosovën?

22 PË. Po.

23 PY. Po në periudhën 1992 deri në 1998, ju nuk keni pasur
24 asnjë lloj përfshirje me Kosovën, apo jo?

25 PË. Jo. Gjatë asaj periudhe kryesisht unë kam qenë në

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 56

1 Ukrainë, domethënë jam marrë në Uashington me çështjet e
2 Ukrainës. Nuk kam pasur lidhje me Kosovën apo me Prishtinën.
3 PY. Në rregull. Dhe informacioni që keni marrë, si e keni
4 marrë, nga pararendësit tuaj, e keni marrë nga njerëz që kanë
5 qenë përpara jush besoj, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Kush ka qenë në Kosovë përpara jush, domethënë përpara se
8 sa të krijohet KDOM-i?

9 PË. Shefi i KDOM-it, i KDOM-it amerikan në atë kohë ka qenë
10 dikush me mbiemrin Williams, në qoftë se nuk gabohet. Ka qenë
11 pjesë e stafit të gjeneralit Weston Clark.

12 PY. A keni pasur shumë ndërveprime me këtë person përpara se
13 sa të zhvendoseshit në Kosovë?

14 PË. Jo. Nuk kam pas absolutisht asnjë lloj shkëmbimi me të
15 përpara se sa të shkoja në Prishtinë.

16 PY. Për sa kohë keni qëndruar aty përpara se sa, ka qenë ky
17 person aty përpara se sa të mbërrinit juve?

18 PË. Pak a shumë një javë.

19 PY. KDOM-i besoj kur keni shkuar fillimisht në Kosovë keni
20 pas shumë pak staf, apo jo?

21 PË. Po. Fillimisht kemi qenë shumë të vegjël në madhësi. Kemi
22 pasur ndoshta nja pesë automjete, 15 persona oficerë ushtarakë
23 edhe oficerë të shërbimit të huaj amerikan.

24 PY. Ju keni përmendur në deklaratën e ZPS-së që prania e
25 vetme zyrtare e qeverisë së Shteteve të Bashkuara në Kosovë ka

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 57

1 qenë një agjenci informacioni e Shteteve të Bashkuara që
2 funksiononte nën Richard Huckabury që punonte me stafin lokal
3 në Kosovë. Kështu është, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Ishte i vetëm nëpunës amerikan që ka punuar atje, apo jo?

6 PË. Jo, ka pasur edhe persona ose staf të tjerë.

7 PY. Jo, e kisha fjalën thjesht për nëpunës të Shteteve të
8 Bashkuara që ishte oficer i Zyrës së Informacionit i Shteteve
9 të Bashkuara, apo jo:?

10 PË. [Nuk ka përkthim]

11 PY. Kur u arrit, kur mbërritët në gusht mendoj që në
12 paragrafin 19 të deklaratës tuaj ju thoni si më poshtë:

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal, është prova
14 materiale 01066.

15 PY. "KDOM-i amerikan ishte krijuar, kishte krijuar kontakte
16 me anëtarë të UÇK-së përpara se sa të mbërrija unë."

17 "Kontaktet e para në atë fazë kanë qenë me grupin e
18 Drenicës, që unë e kuptoj që përfshinin Sylejman Selimin dhe
19 Rexhep Selimin."

20 A ju kujtohet kjo gjë, kjo pjesë e deklaratës tuaj?

21 PË. Po.

22 PY. Si e kuptoni ju këtë gjë, a mund të na e shpjegoni pak më
23 tepër se si keni përfshirë Sylejman Selimin dhe Rexhep
24 Selimin?

25 PË. Këtë ma ka thënë zëvendës koloneli Williams.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 58

1 PY. Kjo është baza e njohurive tuaja. Por a e dini ju që jeni
2 takuar me Rexhep Selimin dhe Sylejman Selimin, pra në qoftë se
3 dikush i ka takuar ata përpara se sa të mbërrinit juve?

4 PË. Nuk di hollësitë, por di që anëtarë të KDOM-it amerikan,
5 me sa mendoj unë, i kanë takuar, kanë qenë personat përgjegjës
6 që janë takuar me ta.

7 PY. A ju kujtohet në qoftë se ata janë takuar me ta apo
8 thjesht e kanë marrë nga një burim tjetër këtë informacion?

9 PË. Nuk e di.

10 PY. Pra, përshtypja është që këto informacione që ju keni
11 dhënë në deklaratë mbështetur në informacionin që ju kanë
12 dhënë kontaktet ose personat që kanë qenë pjesë e KDOM-it
13 përpara se të mbërrinit atje, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 PY. Z. Huckbury nuk është se është takuar, me sa dini juve
16 personalisht, me këto persona, apo jo?

17 PË. Jo.

18 PY. Por nuk është se ka pasur shënime sa i takon këtyre
19 takimeve, apo jo? Besoj që këto janë informacione që jua kanë
20 kaluar gojarisht personat me të cilët ju jeni takuar, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Le të kalojmë tek paragrafi 46 ku flisni për grupin e
23 Drenicës. Paragrafi është pak më i gjatë sesa paragrafi i
24 parë, kështu që do i kërkoja Sekretares të paraqitej në ekran.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është prova materiale 01066 me

1 numër ERN-je 075522. Faqja që kërkoj që të parqet në ekran
2 është 075531, paragrafi 46.

3 PY. Le ta shohim që të paraqitet në ekran, Dëshmitar. Do ta
4 lexoj:

5 "Ne patëm kuptimin se ekzistonte një grup ndonjëherë që
6 quhej 'Grupi i Drenicës', i cili ishte i zgjuar dhe i mençur.
7 Kemi dëgjuar njerëz të sofistikuar që flisnin për ndarjen
8 urbane të vendit dhe ndarjen Drenicë-Prishtinë. Udhëheqja e
9 grupit të Drenicës ishte shumë nacionaliste dhe ideologjike.
10 Prishtina ishte e sofistikuar dhe urbane, dhe këta njerëz
11 kishin frikë se ata nga Drenica do të merrnin përsipër
12 Prishtinën. Ne kemi punuar në mënyrë efektive jashtë
13 Prishtinës edhe jemi shoqëruar me njerëz të rinj të arsimuar
14 dhe të respektueshëm."

15 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë ZPS-së, Dëshmitar?

16 PË. Përmendeni edhe një herë, ju lutem?

17 PY. A ju kujtohet që e keni thënë këtë si pjesë e deklaratës
18 për ZPS-në, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Në fillim të paragrafit, ju thoni, "ne kishim ndjesinë",
21 ose e kuptonim situatën se ekzistonte një grup. Çfarë do të
22 thotë kjo, që e kishit këtë ndjesi se jua kishte thënë dikush
23 tjetër dhe ju kishit krijuar ndjesitë vetë që kjo ishte
24 situata, apo donit të thonit diçka tjetër?

25 PË. Në atë pikë, ne po përpiqeshim që të mblidhnim sa më

1 shumë informacion që të krijonim panoramë për UÇK-në. Dhe e
2 vetmja, i vetmi vështrim ose e vetmja perspektivë që kishim ne
3 në atë kohë ishte fakti që ekzistonte një grup në Drenicë që
4 ishte UÇK. Ne nuk kishim asnjë lloj kontakti tjetër me ata që
5 më pas neve na rezultuan që të ishin zona, pra nuk dinim dhe
6 nuk kishim kontakte lidhur me zonat.

7 PY. Ky informacion mbështetet tek ajo çfarë ju kanë thënë
8 personat e tjerë në Prishtinë, apo jo? Ky ishte burimi juaj i
9 informacionit, mbi këtë mbështeteshit ju?

10 PË. Burimi i informacionit ishte më i gjerë se njohuria që
11 kishin anëtarët e KDOM-it.

12 PY. Pra, kjo ndarja ndërmjet Drenicës dhe Prishtinës, ky
13 informacion, a ju kishte ardhur nga KDOM-i, apo ju kishte
14 ardhur nga këta njerëzit e sofistikuar që ju thoni dhe që i
15 përmendni në këtë paragraf?

16 PË. Kjo përgjigje vjen nga ky grupi më i fundit, domethënë ky
17 grupi i sofistikuar që ishin kryesisht të rinj, shqiptarë
18 Kosove të rinj, të miredukuar, gazetarë, persona si për
19 shembull Blerim Shali, Veton Surroi i *Kohës Ditore*, persona të
20 kësaj natyre. Albin Kurti po ashtu, i cili në atë kohë punonte
21 për Demaçin. Domethënë e kam fjalën për persona të tillë, me
22 këto cilësi.

23 Njëri prej tyre tha në një pikë, dhe kjo është diçka që
24 nuk do ta harroj kurrë, e kam ngulitur në mendje, ata flisnin
25 për ndasitë, dallimet tradicionale kulturore ndërmjet Drenicës

1 dhe Prishtinës. Prishtina ishte qendra tregtare dhe
2 institucionet qeveritare. Aty gjendet dhe Universiteti i
3 Prishtinës. Në njëfarë kuptimi ishte qendra e kulturës së
4 lartë të vendit. Ndërkohë që sa i takon Drenicës, Drenica
5 ishte një zonë e largët në disa kuptime në atë kohë, që sipas
6 mendimit të tyre përbëhej kryesisht ose dominohej nga
7 fshatarë. Megjithatë, njëri prej këtyre personave në këtë
8 kontekst bisede tha që UÇK-ja përfaqësonte një njësi ose grup
9 rebelësh fshatarësh kundër LDK-së, dhe përfaqësues urbanë
10 qytetarë dhe të sofistikuar të cilët përfaqësoheshin nga
11 presidenti Rugova.

12 PY. Kush jua ka thënë këtë gjë, në qoftë se ju kujtohet? Na e
13 thoni pak ju lutem?

14 PË. Nuk më kujtohet personi konkret, kush e ka thënë këtë gjë
15 konkretisht. Megjithatë e ka thënë njëri prej këtyre
16 intelektualëve të rinj me të cilët ne bisedonim dhe që e
17 njoftëm në qytet.

18 PY. Po këto perceptime nuk është se ishin nga ndërveprimi që
19 ju keni pas vetë me këtë gazetar, apo jo?

20 PË. Jo, jo.

21 PY. Kur njerëzit flasin për grupin e Drenicës -- ta nis
22 ndryshe fjalinë. Nuk është e saktë që të thuhet që kur flasin
23 për grupin e Drenicës ata e kanë fjalën për individë konkretë,
24 apo jo?

25 PË. Po, është konstatim i drejtë.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 62

1 PY. Domethënë, thjesht bëhet një vlerësim i përgjithshëm i
2 ndarjes midis qytetit dhe fshatit, në njëfarë mënyre apo jo?

3 PË. Po, është e saktë.

4 PY. Le të kalojmë tek tema e radhës, Dëshmitar.

5 Dëshiroj të flasim lidhur me takimet tuaja me Rexhep
6 Selimin, me ndërveprimin që keni pas me Rexhep Selimin. Në
7 deklaratën që i keni dhënë ZPS-së ju konfirmoni, të paktën me
8 aq sa ju kujtohet, që jeni takuar me të, me 18 gusht 1998, në
9 Likovc. A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë gjë ZPS-së?

10 PË. Po.

11 PY. A ju kujtohet takimi konkret?

12 PË. Po.

13 PY. Ky ka qenë takimi i parë që ju keni pas me UÇK-në që prej
14 kohës kur mbërritët në Prishtinë, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Domethënë, këto takime i keni pasur nja 5-6 ditë pasi
17 mbërritët në Kosovë?

18 PË. Po.

19 PY. A ju kujtohet se si u organizua takimi, si ndodhi që u
20 takuat?

21 PË. Me sa më kujtohet, Adem Demaçi organizoi takimin. Ai bëri
22 organizimet për të. Mua më kujtohet që u takova me të në
23 Likovc, ose në afërsi të Likovcit.

24 PY. Në deklaratën tuaj, në paragrafin 50, ju thoni që
25 dëshiron që të takoheshit me sa më shumë pjesëtarë të UÇK-së

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 63

1 që të ishte e mundur në mënyrë të tillë që të kuptonit tiparet
2 e strukturës së komandës të operacioneve logjistike dhe të
3 synimeve politike. A ju kujtohet t'ia keni thënë Prokurorit
4 këtë?

5 PË. Po.

6 PY. Ky takimi që keni pas me z. Selimi ka qenë një prej atyre
7 takimeve, se ju po përpiqeshit që të takonit sa më shumë
8 njerëz të ishte e mundur, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Po, e saktë është kjo. Megjithatë më lejoni që të shtoj
10 se Uashingtoni ishte i gatshëm dhe i interesuar që të dinte sa
11 më shumë të ishte e mundur lidhur me UÇK-në, sepse situata,
12 dhe qoftë kjo situata politike dhe situata ushtarake në
13 Kosovë, po përkeqësohej, kështu që kishte shqetësime që
14 kryengritja po shpërndahej dhe që administrata e Clinton ishte
15 e shqetësuar që në qoftë se situata do të dilte jashtë
16 kontrollit, Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja do përballëshin me
17 një Bosnjë të dytë.

18 PY. E kuptojmë. Gjatë këtij takimi, z. Selimi nuk u
19 prezantua. Domethënë kur flas, kur them "z. Selimi", e kam
20 fjalën për Rexhep Selimin që të kuptohemi, Dëshmitar.

21 Z. Selimi nuk është se u prezantua që ishte komandant i
22 përgjithshëm ose drejtues, ose udhëheqësi kryesor i UÇK-së,
23 apo jo?

24 PË. Po, kështu ka qenë. Nuk e ka prezantuar veten si të
25 tillë.

1 PY. Dhe ju nuk i jeni referuar atij asnjëherë, nuk i jeni
2 drejtuar asnjëherë atij si drejtues kryesor i UÇK-së, apo jo?
3 Megjithëse juve në atë takim jeni marrë vesh me të përmes
4 përkthimit, apo jo?

5 PË. Me sa më kujtohet, kishte dy Selima, ishte Sylejman
6 Selimi i cili po ashtu ishte i pranishëm aty me Rexhep
7 Selimin. Dhe me sa më kujtohet, thjesht ata u prezantuan si
8 zyrtarë të lartë të UÇK-së.

9 PY. A ju kujtohet që çfarë tha konkretisht z. Selimi,
10 domethënë Rexhep Selimi?

11 PË. E vetmja gjë që më kujtohet është që ne ishim të
12 mirëpritur që UÇK-ja na mikpriste dhe që KDOM-i ishte i
13 mirëpritur në Kosovë.

14 PY. Po ju thoni që e mbani mend që z. Selimi ka folur gjatë
15 atij takimi dhe kjo ju ka bërë juve që ta fiksoni atë se
16 personi ishte një prej drejtuesve të lartë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Por nuk është se kishte ndonjë gjë tjetër në atë takim,
19 nuk kishte ndonjë përmbajtje tjetër që juve morët përmes
20 përkthimit, apo jo?

21 PË. Jo.

22 PY. Dhe besoj që ai ka folur në shqip, përderisa ju e keni
23 marrë bisedën, përmbajtjen e bisedës me të përmes përkthimit,
24 sepse ai nuk ka folur në anglisht në atë kohë, apo jo?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 65

1 PY. Në takim, a ju krijua përshtypja që UÇK-ja ishte një
2 partner me të cilët ju mund të kishit marrëdhënie, se ju keni
3 përmendur marrëdhëniet publike si një aspekt të rëndësishëm të
4 takimeve në deklaratën tuaj?

5 PË. Kjo nuk më kujtohet. Megjithatë ajo që më kujtohet është
6 që ai shprehu interes të konsiderueshëm për zhvillimin e një
7 dialogu të vazhdueshëm partneriteti me Shtetet e Bashkuara.

8 PY. Le të kalojmë tani tek ajo çfarë besonit ju se luante si
9 rol ai brendapërbrenda UÇK-së sepse ka interpretime të
10 ndryshëm në kabllogramet, kështu që do të doja të sqaroja pak
11 rolin e tij brenda UÇK-së.

12 Së pari, duke folur për kabllogramet, ju keni thënë në
13 intervistën e ZPS-së që ato mbështeteshin në informacionet që
14 ju merrnit nga burime të ndryshme, pjesa dërrmuese e të cilave
15 nuk ishte e verifikuar. A ju kujtohet kjo gjë?

16 PË. Po.

17 PY. Domethënë ju merrnit informacion lidhur me rolin e
18 personave të caktuar si z. Selimi dhe ju nuk e kishit
19 mundësinë që të bënit verifikimin e informacionit në qoftë se
20 informacioni ishte i vërtetë apo jo përpara se sa të shkruanit
21 kabllogramin. Kështu, Dëshmitar?

22 PË. Ne gjithmonë mundoheshim që të sqaronim që një
23 informacion të caktuar nuk e konfirmonim dot, pra thjesht që
24 ishte informacion i pakonfirmuar.

25 PY. Le të marrim një kabllogram dhe ta analizojmë pak.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 66

1 Kablllogrami i datës 3 nëntor 1998.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ka numrin e provës materiale
3 P10167 [Sipas përkthimit] me numër ERN-je 075300 dhe faqja
4 konkrete që dua të paraqitet në ekran është 07303 [Sipas
5 përkthimit].

6 PY. Paragrafi 9(c) në mes të faqes. Tek rreshti 4, tek
7 paragrafi që keni përpara, paragrafi 9. Thuhet:

8 "Në Drenicë, komandanti ushtarak është Rexhep Sulltan
9 Selimi dhe homologu i vet politik është Hashim Thaçi."

10 A e shikoni këtë referencën, a e shikoni që emri është
11 shkruar Rexhep Sulltan Selimi?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe shpeshherë para Trupit Gjykses ju keni thënë Sulltan
14 Selim në vend të Sylejman Selimit, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. E keni ngatërruar me nofkën e tij, apo mendoni që në vend
17 që të thoni Sylejman Selimi, thoni Sulltan Selimi.

18 PË. Mendoj që e them gabim. Them Sulltan në vend të Sylejman.

19 PY. Dhe Sylejman Selimi ka qenë komandant i zonës, apo jo? E
20 mbani mend këtë gjë? Ka qenë komandant ushtarak?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe kjo ka ndodhur si rezultat i gabimit që është
23 reflektuar edhe në kablllogram, apo jo?

24 PË. Më lejoni ta sqaroj pak këtë sepse ishim në errësirë të
25 plotë, në veçanti sa i takon organizimit dhe personaliteteve.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Page 67

1 E kam fjalën këtu për personalitete ose zyrtarë të lartë të
2 UÇK-së. Veçanërisht kur flitej për Rexhepin, kishim dëgjuar të
3 gjithë llojet e gjërave, domethënë dëgjonim lloj-lloj gjërash
4 sa i takon detyrave të tij, se për çfarë ishte përgjegjës
5 gjatë kohës që ka qenë në UÇK. Mua personalisht nuk më
6 kujtohet ta kem parë atë shpesh, pas takimit të parë për të
7 cilin po diskutojmë. Jam i sigurt që e kam parë në grumbullime
8 të mëdha, por nuk është se ka qenë personi im i parë i
9 kontaktit ose ndër personat kryesorë të kontaktit.

10 PY. Me aq sa kuptoj unë, ajo të paktën që thuhet në shënimin
11 përgatitor ku ju bëni sqarime për pjesë të caktuara të ditarit
12 tuaj, ku ka qenë i përmendur emri i tij më datë 5 shkurt, ne
13 në fakt e shohim vetëm aty në 5 shkurt, por nuk është se e
14 shikojmë gjëkund tjetër në ditarin emrin e Rexhep Selimit.

15 A përkon kjo me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me
16 Rexhep Selimin, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Në rregull. Të vazhdojmë pak më poshtë në këtë
19 kabllogram. Jo, në fakt i referohem asaj çfarë thatë pak më
20 sipër që thatë që kemi dëgjuar lloj-lloj gjërash sa i takon
21 përgjegjësive që kishte z. Selimi. Nga i keni dëgjuar këto
22 gjëra, Dëshmitar?

23 PË. Nuk i kemi dëgjuar nga anëtarët e ekipit që bënë
24 patrullë. Por, kryesisht ishin informacione që i dëgjonim nga
25 personat e kontaktit me të cilët u takuam në Prishtinë,

1 personat e tillë si Surroi, Shala, Baton Haxhiu, *Koha Ditore*,
2 pra, e përditshmja, *Koha Ditore*, dhe shumë gazetarë të tjerë
3 të cilët punonin në terren për këto dy gazeta kryesore, ose
4 për strukturat ndërkombëtare, për bashkësinë ndërkombëtare.
5 Domethënë për këto rrjete e kam fjalën. Këto ishin kryesisht
6 burimet tona. Ne keni pasur kontakte të mira me ta sepse
7 zakonisht ishin burime të mira informacioni. Jo gjithmonë
8 ishin të besueshme, por të paktën ata kishin më shumë kontakte
9 se sa ne. Ata kishin më shumë marrje e dhënie me UÇK-në në
10 fushën për të cilën ne ishim të interesuar. Ata e flisnin
11 shqipen, ishin shqiptarë, kishin simpati për UÇK-në dhe ata
12 jepnin informacion. Thonin fjalë lidhur me ato çfarë kishin
13 dëgjuar.

14 PY. Për këto fjalë jam më shumë i interesuar. Mendoj që e
15 thoni këtë në deklaratën tuaj, konkretisht në paragrafin 59,
16 flisni për disa fjalë të tjera që kishit dëgjuar që
17 qarkullonin për z. Selimi. Mbase origjina e tyre janë po të
18 njëjtat burime që përmendët më përpara. Por besoj që e keni
19 pranuar dhe në deklaratën tuaj që këto fjalë nuk ishin të
20 vërteta.

21 Së pari, ishin fjalë që qarkullonin, që Rexhep Selimi
22 ishte përgjegjës për policisë ushtarake ose për njësinë
23 speciale të policisë. Kjo thuhet në paragrafin 59 të
24 deklaratës tuaj. A ju kujtohet që t'ia keni thënë Prokurorisë
25 këtë gjë, Dëshmitar?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Page 69

1 PË. Po.

2 PY. Por, po ashtu ju pranoni që keni dëgjuar fjalë që ai ka
3 qenë inspektor i përgjithshëm i UÇK-së?

4 PË. Po, edhe këtë. Më kujtohet që kjo, këto fjalë ishin më të
5 besueshme në krahasim me fjalët e tjera që kishim dëgjuar për
6 të. Megjithatë më kujtohet në diskutime më të vonëta të
7 Shtabit të Përgjithshëm, në veçanti Sokol Bashota dhe Jakup
8 Krasniqin, dhe Ramë Bujën, me të cilin kemi parë më shpesh dhe
9 kemi pasur më shumë biseda me ta, dhe konstatuam që me kalimin
10 e kohës ata ishin më shumë të hapur për të ndarë informacion
11 me neve lidhur me stafin, me personelin e UÇK-së. Kështu që më
12 kujtohet që në një pikë të caktuar, dikush prej tyre më tha që
13 Selimi ishte inspektori i përgjithshëm i UÇK-së.

14 PY. Në të njëjtin paragraf në deklaratën e ZPS-së, ju
15 përmendni që keni dëgjuar nga një bashkëbisedues lidhur me
16 faktin që z. Selimi, besoj që ju sugjeroni që z. Selimi ishte
17 përgjegjës për "Tigrat e Zinj", në atë deklaratë, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Po ju besoj që e pranoni që kjo ishte e pasaktë apo jo,
20 dëshmitar?

21 PË. Edhe këto ishin fjalë që qarkullonin.

22 PY. Unë këtë po mundohem të nxjerr në pah, që kishte shumë
23 fjalë që qarkullonin, njerëzit thonin gjëra të caktuara,
24 njerëz që mbase ju mund t'ju dukeshin të besuar, por jepnin
25 informacione të cilat nuk qëndronin, apo jo?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 70

1 PË. Po. Rexhepi së bashku me z. Thaçi, veçanërisht në fillim
2 fare, këto dy ishin shumë figura misterioze për ne.
3 PY. Dhe së bashku me këtë misterin që i rrethonte ata, besoj
4 që e diskutuam dhe dje këtë gjë, ky ishte një mister që
5 mbështetej në mënyrë legjitime për shqetësimet e sigurisë
6 lidhur me informacionet ose frikës që mund të binte
7 informacioni në duart e gabuara. Dhe me "duart e gabuara" e
8 kam fjalën këtu për duart e inteligjencës serbe. Dhe kjo mund
9 të ishte shumë e rrezikshme, domethënë, dhënia e informacionit
10 jo vetëm për ta, por edhe për anëtarët e familjes.
11 PË. Po. Sa për ta përsëritur dhe një herë. Nick Turnbull, nga
12 KDOM-i i BE-së, mendonte që kujdesi që ushtronte UÇK-ja për
13 ndarjen e informacionit me ne lidhur me strukturën, mënyrën e
14 organizimit, personelin e vet, duke marrë parasysh zhvillimet,
15 rrethanat, edhe pse nuk na pëlqente, ne donim që të dinim sa
16 më shumë që të ishte e mundur. Megjithatë, e thashë dhe dje,
17 dua ta theksoj dhe sot, ne mendonim që kujdesi i tyre ishte
18 absolutisht legjitim.
19 PY. Në rregull. Dua që të diskutojmë gjithashtu edhe
20 përmbajtjen e një kabllogrami tjetër.
21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është prova materiale P1069, ka
22 disa informacione këtu për z. Selimi, dhe mendoj që këto
23 informacione ilustrojnë të njëjtin argument që ngrita më
24 herët. Për procesverbal bëhet fjalë për ERN numër 075316. Në
25 faqen 075323.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 71

1 PY. Në paragrafin 7 në këtë dokument -- nuk e di, e shikoni
2 këtë dokument përpara në ekran, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Në rreshtin e pestë, nga fundi. Kur flisni për
5 identifikimin e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, flisni
6 këtu për Hashim Thaçin. Dhe më pas thuhet:

7 "Rexhep Selimi, drejtor politik i zonës së Drenicës dhe
8 mbase shef i Drejtorisë së Inteligjencës ose të Informimit të
9 Shtabit të Përgjithshëm."

10 A e shikoni këtë gjë?

11 PË. Po.

12 PY. Të paktën këtu kemi dy role të tjera që i caktohen z.
13 Selimi që në fakt nuk përkojnë me realitetin. Besoj se
14 pajtoheni me mua lidhur me këtë, Dëshmitar, apo jo?

15 PË. Po. Ky është një informacion që është i gabuar.

16 PY. Besoj që ju e pranoni në deklaratën tuaj që ca gjykime që
17 i keni krijuar, ose informacione që keni marrë, kanë qenë të
18 gabuara, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Në rregull.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Së fundi, në faqen 330, pra që
22 është ERN 075330, nga i njëjti kabllogram, do të doja që t'ju
23 kujtoja të shikonim paragrafin 14, nga fundi i faqes. Në këtë
24 paragrafin thuhet që:

25 "Thaçi ka qenë në Evropën Perëndimore së bashku me Rexhep

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 72

1 Selimin dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm...”

2 A e shikoni këtë rreshtin këtu, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. A e dini që z. Selimi nuk është larguar asnjëherë gjatë
5 asaj kohe nga Kosova?

6 PË. Jo. Në atë kohë nuk e di.

7 PY. Në rregull. Faleminderit. Këto ishin të gjitha pyetjet e
8 mia. Nuk e di në qoftë se keni ndonjë gjë për të sqaruar, por
9 në të kundërtën mbarova me pyetjet, nuk kam pyetje të tjera.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Ellis, fjala është për ju.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës. Vetëm një
13 moment kohë dëshiroj, ju lutem.

14 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

15 Z. ELLIS: [Përkthim]

16 PY. Mirëdita, z. Byrnes. Unë quhem Aidan Ellis dhe unë
17 përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Më dëgjoni mirë? Se e shoh që po
18 ia afroheni mikrofonit.

19 PË. Edhe një herë emrin, ju lutem?

20 PY. Aidan Ellis, dhe përfaqësoj z. Jakup Krasniqi.

21 PË. Kënaqësi që shihemi.

22 PY. Unë do t'ju bëj disa pyetje edhe mbasdite, ditën e sotme,
23 pra, do të vazhdojmë me ato pyetje deri atëherë. Ju sapo
24 konfirmuat në një nga përgjigjet që i dhatë z. Roberts, që
25 Jakup Krasniqi ka qenë një nga pjesëtarët e UÇK-së të cilët ju

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 73

1 i keni takuar në një frekuencë më të shpeshtë gjatë

2 konfliktit, është e saktë kjo?

3 PË. E saktë.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran

5 dokumentin 119118, ju lutem. Dhe të kalojmë në fund të faqes.

6 PY. Z. Byrnes, kjo është një bisedë që ju keni bërë me

7 Prokurorinë në dhjetor të vitit 2023. Dhe këtu në paragrafin 2

8 ju thoni që "Krasniqi ishte i arsyeshëm dhe Byrnes kishte

9 besim tek ai". Kjo referencë është për Jakup Krasniqin, apo

10 jo?

11 PË. Po, ashtu është.

12 PY. Dhe ju kishit një marrëdhënie të mirë me të nga takimet

13 që kishit patur gjatë konfliktit, apo jo?

14 PË. Po, ashtu është. Gjatë asaj kohe unë isha i mendimit, nuk

15 e di se çfarë kishte ai, por unë isha i mendimit që ne kishim

16 krijuar një besim të ndërsjellë me njëri-tjetrin. Dhe në të

17 gjitha ato takime që kemi patur, në një sërë krizash që

18 ndodhën, ai punoi fort, vërtet fort, që të bashkëpunonte me

19 ne. Punoi fort që të zgjidheshin ato kriza, dhe pjesërisht

20 ashtu siç e kam thënë edhe këtu, motivimi i tij ka qenë

21 qartazi si një person i lidërsipit të UÇK-së, që SHBA-ja të

22 ishte në anën e tyre.

23 Megjithatë, unë pata, kisha një ndjesi që ai ishte shumë

24 i njerëzishëm. Ishte serioz. Ishte vërtet shumë i inatosur për

25 gjithçka që serbët u kishin bërë shqiptarëve, popullit të vet,

1 por në fakt ai ishte njeri që e donte paqen. Dhe donte që kjo
2 gjë të përfundonte. Gjithashtu -- meqë ra fjala, nuk e di nëse
3 e dini ju fjalën "besa", e dini se çfarë do të thotë? Ishte e
4 qartë që ai ishte një individ i cili jetonte sipas parimeve të
5 besës, dhe këtu e kam fjalën për faktin që ai ishte një nga
6 ata persona që po të na e jepte fjalën që diçka do të ndodhte,
7 do të kryhej, atëherë ne mund të largoheshim me besimin më të
8 plotë të mundshëm që ashtu do të bëhej vërtet. Pra, kishte një
9 masë, një shkallë shumë të madhe besimi ndërmjet nesh.

10 Megjithatë, edhe ne kemi patur momentet tona me njëri-
11 tjetrin. Kemi pasur shumë mosmarrëveshje, për shembull, mbaj
12 mend një rast kur ai ishte aq i inatosur me mua sa doli nga
13 dhoma me furi, dhe nuk mund ta mbaj mend tani se për çfarë
14 bëhet fjalë, sepse ka kaluar kaq shumë kohë që atëherë. Por e
15 mbaj mend që doli me një shpejtësi të madhe gjithë inat nga
16 dhoma, por pastaj u kthye. Dhe e punuam, e rregulluam, çfarëdo
17 lloj problemi që ka qenë ai, jam i sigurt që ne e zgjidhëm pra
18 disa e kemi zgjidhur.

19 Dhe çështja tjetër e rëndësishme, dhe ndoshta ju do të
20 dëshironi që të flisni për këtë më vonë ose tani në fakt. Një
21 shembull tjetër i dëshirës së tij që u manifestua, pra, për të
22 gjetur zgjidhje, ka qenë incidenti i 13 janarit në Likovc, në
23 të cilin bëhej fjalë për Bill Walker, ambasadorin Walker, dhe
24 ambasadorin Chris Hill të SHBA-së, si dhe Wolfgang Petritsch
25 të Austrisë, i cili ishte dhe përfaqësuesi i posaçëm i

1 Bashkimit Evropian, u takuan me trojkën, në mënyrë që të
2 përpiqeshin që të gjendej marrëveshje në lidhje me shkëmbimin
3 e robërve të luftës. Pra, ishin tetë ushtarë të ushtrisë
4 jugosllave të cilët kishin arritur në një vend ku ishte UÇK-
5 ja, dhe ishin nëntë ushtarë të UÇK-së të cilët ishin kapur nga
6 forcat serbe që po përpiqeshin që nga Shqipëria të hynin në
7 Kosovë. Dhe ky takim ishte një takim plot debate.

8 Në fakt, si unë, ashtu edhe Nick Turnbull ishim aty si
9 ekspertë. Nuk është se morëm pjesë në diskutime vetë. Por në
10 një moment të caktuar ambasadori Hill dhe ambasadori Walker u
11 frustruan aq shumë sa u çuan në këmbë dhe dolën nga dhoma, dhe
12 thanë që nuk do të punonin dot kurrë me UÇK-në në këtë mënyrë
13 sepse ishin shumë kokëfortë, obstruksionistë, pra krijonin
14 pengesa, e të tjerë, e të tjerë, e të tjerë, e të tjerë. Unë
15 dhe Jakupi si edhe David Meyer i cili ishte ish-ushtarak
16 britanik, por bashkë me një nga ndihmësit e tij, u bënë bashkë
17 dhe të gjithë ramë dakord që duhej patjetër që ta zgjidhnim
18 këtë problem. Se ishte një problem që mund të zgjidhej në
19 mënyrë që të ecnim përpara. Dhe Wolfgang Petritsch ndejti,
20 faktikisht, ai, Jakupi dhe kolegët e Jakupit, vazhduan, e
21 vazhduan, e vazhduan negociatat dhe më pas arritën në një
22 marrëveshje.

23 Dhe në fund, pengesa kryesore kishte qenë rendi i lirimit
24 të këtyre të burgosurve. Sepse serbët donin që të kishte një
25 hapësirë të madhe kohore nga njëri tek tjetri. Kjo për arsye

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 76

1 të marrëdhënieve me publikun. Ndërsa UÇK-ja donte që të
2 ndodhte shkëmbimi në të njëjtën kohë i të gjithëve. Dhe u
3 zgjidh më pas, dhe Jakupi luajti një rol kyç në të gjithë këtë
4 situatë. Ai vazhdoi këmbënguli derisa u zgjidh.

5 PY. Do t'i kthehem kësaj negociate më pas dhe do të hyjmë në
6 të në hollësi. Por ajo që po na thoni ju me pak fjalë është që
7 edhe pse ka patur disa negociata të vështira, z. Krasniqi
8 ishte një person tek i cili ju kishit besim dhe me të cilin
9 mund të punonit.

10 PË. Po.

11 PY. Dhe një person i cili ishte vërtet i njerëzishëm dhe
12 ishte njerëzor.

13 PË. Po, dhe nëse mund të them edhe një gjë tjetër. Në Likovc,
14 në 13 janar, ai m'u afrua dhe ndërkohë që gjëja ishte
15 përmbyllur dhe u kthye Walker në takim, dhe pastaj doli dhe
16 lexoi një deklaratë për shtypin që ishte mbledhur aty, Jakupi
17 m'u afrua dhe më tha që komandanti i zonës, që në atë kohë
18 ishte Sami Lushtaku, po mbante disa fshatarë serbë të cilët i
19 kishin rrëmbyer, me ç'mbaj mend unë, një ditë më parë. Dhe
20 Jakupi më tha, "Po të duash ne mund t'i lirojmë ata", dhe ai e
21 mori situatën në dorë ndërkohë që Lushtaku nuk donte ta bënte
22 këtë gjë. Por Jakupi dha urdhër që të liroheshin dhe ata u
23 liruan dhe na u dorëzuan ne, kështu që ai s'kishte pse ta
24 bënte këtë gjë, apo jo? Nuk ishte i detyruar ta bënte, por
25 donte ta bënte.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 77

1 PY. Do t'i kthehemi kësaj çështje edhe pas drekës.

2 Megjithatë, kam të drejtë kur them që në ato momente dhe pse
3 shqipja juaj ishte e kufizuar, ju mund të flisnit serbisht,
4 apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe ka patur momente kur ju me UÇK-në keni folur në
7 serbisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo jo?

8 PË. Ne në fakt flisnim me njëri-tjetrin gjithë kohën në
9 serbisht.

10 PY. Pra, pa hezituar?

11 PË. Unë nuk flisja fare shqip dhe kur duhet të lidhesha në
12 telefonin satelitor dhe t'u bëja thirrje për ndihmë, për
13 shembull, kjo nuk bëhet zakonisht me anën e një përkthyesi,
14 kur takoheshim me trojkën, me Ramë Bujën, me Sokol Bashotën,
15 ne sillnim përkthyes me vete, dhe në atë takime ka patur
16 përkthim.

17 PY. E kuptova. Pra në bisedat telefonike ju flisnit me z.
18 Krasniqi në serbisht?

19 PË. Po.

20 PY. Ai nuk hezitonte që të fliste në serbisht me ju?

21 PË. Jo.

22 PY. Dhe ju besoj që e dinit nga puna që bëtë me të që ai
23 ishte një person i arsimuar, ishte profesor historie, apo jo?

24 PË. Po, ne kishim interesa të përbashkëta, sepse dhe unë, me
25 formim ishte historian.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 78

1 PY. Dhe ju e dinit që ai ishte burgosur nga serbët në vitet

2 1980 si i burgosur politik?

3 PË. Po, e dija.

4 PY. Dhe ju e dinit që ai kishte qenë kryetar i LDK-së në

5 Drenovc, apo jo?

6 PË. Po, e dija.

7 PY. Dhe ju e dinit që ai ishte zëdhënësi i UÇK-së?

8 PË. Ne e kishim kuptuar që ishte zëdhënësi i UÇK-së.

9 PY. Dhe kur u takuat, kur takoheshit me z. Krasniqi ai
10 zakonisht ishte me Sokol Bashotën dhe Ramë Bujën?

11 PË. Zakonisht po.

12 PY. Dhe zakonisht këto ishin gjëra që ju i kishit kuptuar
13 edhe nga Shtabi i Përgjithshëm dhe edhe për takimet me
14 ndërkombëtarët?

15 PË. Po.

16 PY. Në fakt folët pak për këtë sot në mëngjes, por me
17 ç'kishit kuptuar ju, shefi i operacioneve i UÇK-së ishte
18 Bislime Zyrapi, apo jo?

19 PË. Më falni, mund ta përsërisni pyetjen?

20 PY. Me ç'kishit kuptuar ju, Bislime Zyrapi ishte shefi i
21 operacioneve i UÇK-së?

22 PË. Po, ai u prezantua si i tillë me këtë rol.

23 PY. Kështu që kur diskutoheshin çështje operative,
24 operacionale, ishte Bislime Zyrapi ai që vinte në takime dhe
25 fliste për këtë çështje?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 79

1 PË. Po, por kjo ndodhi shumë rrallë. Në fakt unë më shumë e
2 kam takuar Bislím Zyrápin kur ne kemi qenë në Tiranë, në
3 Shqipëri, gjatë ndërhyrjes. Nuk është se kemi qëndruar në
4 Kosovë pasi NATO-ja filloi bombardimet e Serbisë.

5 PY. Atëherë, le të shikojmë disa nga kabllogramet.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Kabllogrami i pari është P01072. Të
7 kalojmë pak poshtë që të shikojmë se cila është pjesa e duhur.
8 Pra, të kalojmë në faqe, në pjesën e poshtme, ose ndoshta
9 është faqja tjetër e radhës.

10 PY. Këtu bëhet fjalë për një takim ndërmjet Larry Rossin,
11 Sokol Bashotës, Ramë Bujës dhe Jakup Krasniqit në dhjetor të
12 1998, në 22. Dhe ju keni qenë në atë takim, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe formati i këtyre kabllogramëve ishte i njëjtë që
15 fillohet me një përmbledhje të shkurtër dhe hollësitë vijnë më
16 pas, apo jo?

17 PË. Po, ky është formati që ne kemi kopjuar nga shërbimi
18 diplomatik britanik.

19 PY. Po, pra. M'u duket sikur e kisha parë edhe herë tjetër
20 pikërisht këtë gjë.

21 Tani, ju lutem të kalojmë tek përmbledhja, në faqen
22 116681. A është e saktë që në takim, z. Krasniqi tha që "UÇK-
23 ja as nuk i dënonte dhe as nuk i përdorte sulmet terroriste --
24 nuk miratonte, por as nuk i përdorte sulmet, taktikat
25 terroriste, dhe që pa hezitim ai dënoi vrasjet e fundit në

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 80

1 Pejë që kishin ndodhur në Velika Slatina". Dhe kjo në fakt i
2 shkon për shtat pikërisht asaj që ju keni menduar për të, apo
3 jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe asaj që ju mbani mend për takimet?

6 PË. Po.

7 PY. Atëherë, nëse mund të kalojmë në faqen tjetër, e cila
8 është faqja 116683, dhe këtu jepen hollësi të mëtejshme. Dhe
9 këtu thuhet që z. Krasniqi ka thënë si Shtabi i Përgjithshëm
10 ashtu dhe Adem Demaçi, pra përfaqësuesi i vet politik, kishin
11 bërë deklaratat politike që dënonin vrasjet e fundit që kishin
12 ndodhur.

13 Edhe një herë, a e mbani mend kështu që ka ndodhur në
14 këtë takim?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe z. Krasniqi sugjeroi që këto vrasjet e fundit ishin
17 ose puna e policia sekrete të Serbisë ose e agjentëve të tyre
18 për të diskredituar UÇK-në, apo jo?

19 PË. Po, ashtu është.

20 PY. Dhe po të shikojmë pak më poshtë, në përgjigje të një
21 pyetjeje, z. Krasniqi ka thënë që UÇK-ja nuk i kontrollonte të
22 gjithë civilët e armatosur shqiptarë dhe tha që kishte disa
23 grupe të veçuara që thoshin që ishin të UÇK-së, por që nuk
24 ishin nën kontrollin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe
25 që kishin kryer veprime që kishin dëmtuar imazhin e UÇK-së,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 81

1 apo jo? Ishin të pabindur, pra.

2 PË. Po.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe tani të kalojmë tek deklaratata
4 juaj, e cila është dëshmia juaj, 0755522 [Sipas përkthimit]
5 dhe po shoh paragrafin 62, në faqen 75535.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal kemi
7 të bëjmë me numrin P01066.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

9 PY. Në kohën kur është hartuar dëshmia juaj, ka qenë 25 vite
10 pasi kanë ndodhur ngjarjet. Megjithatë, ajo që thuhet në këtë
11 deklaratë, është që:

12 "Krasniqi ia hidhte fajin FARK-ut, por që ne ishim
13 skeptikë për këtë dhe gjithashtu pretenduam se ishte punë e
14 policisë sekrete serbe."

15 Por kabllogrami nuk thoshte pikërisht këtë gjë në atë
16 kohë, pra ai thoshte që sulmi ishte punë e policisë sekrete
17 serbe, dhe më pas u tha që ishte FARK-u që e ka kryer sulmin,
18 por që nuk ishte në kontrollin e UÇK-së, apo jo?

19 PË. Po, ashtu është.

20 PY. Atëherë, nëse mund të vendosim në ekran, ju lutem,
21 dokumentin me numrin P00306, që -- ose SPOE4000799. Në fakt
22 nuk e kisha fjalën për këtë faqe, të paktën në anglisht,
23 kërkoj Deklaratën Politike numër 21. Ka një faqe të dytë të
24 këtij dokumenti? Faleminderit.

25 PY. Atëherë, z. Byrnes, duke parë paragrafin e katërt të

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 82

1 kësaj deklaratë politike, thuhet që:

2 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm,
3 është distancuar shpesh shumë herë deri më tash nga çdo lloj
4 forme dhune kundër qytetarëve të pambrojtur dhe të
5 paarmatosur."

6 E shihni këtë gjë?

7 PË. E shoh.

8 PY. Dhe vijon duke thënë që:

9 "UÇK-ja nuk është as, nuk janë as prapa këtij krimi, pra,
10 nuk e kanë kryer ata, as nuk e kanë filluar, pra, këtë krim të
11 të rinjve serbë në një lokal në Pejë. Nuk janë nxitësit e
12 saj."

13 Kësaj po i referohej z. Krasniqi në takimin që pamë në
14 kabllogram kur ai tha që Shtabi i Përgjithshëm e ka dënuar?

15 PË. Dhe një herë, ju lutem?

16 PY. A është kjo deklaratë politike së cilës po i referohej z.
17 Krasniqi kur ai tha që vrasjet në Pejë ishin dënuar nga Shtabi
18 i Përgjithshëm i UÇK-së?

19 PË. Po.

20 PY. Në rregull. Dhe ju folët pak për këtë gjë me z. Misetic,
21 pak më herët sot. Dhe në fakt konfirmuat që i keni ndjekur
22 disa nga zhvillimet e fundit në lidhje me rastin e lokalit
23 Panda, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe me ç' duket nga to, z. Krasniqi po ju tregonte të

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 83

1 vërtetën, nuk është se donte të hiqte fajin nga vetja, por që
2 në fakt kanë qenë agjentët serbë që e kanë kryer këtë gjë.
3 PË. Po, dhe më duhet të them që u habita, mbeta pa fjalë nga
4 Vucic, i befasuar nga deklarata e Vucic që pamë para se të
5 bënim pushimin sot.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund t'i kthehemi atëherë
7 kabllogramit, i cili ka numrin përkatës që është P01072. Kemi
8 të bëjmë me faqen 116682, paragrafin 4 të saj.

9 PY. Është e vërtetë, apo jo që z. Krasniqi ka thënë që UÇK-ja
10 në parim nuk ishte kundër bisedave, pavarësisht se kishin
11 parakushte për negociatata.

12 PË. Po, është e saktë.

13 PY. Dhe një prej tyre ishte, prej këtyre parakushteve ishte
14 dhe lirimi i të burgosurve politikë shqiptarë?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe ju besoj që do ta kishit ditur në atë kohë që kishte
17 një numër të madh të të burgosurve politikë shqiptarë në atë
18 kohë?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe që ai, ky ishte një shqetësim i delegacionit shqiptar
21 në të gjitha negociatat, apo jo?

22 PË. Po.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë, a mund të kalojmë tani tek
24 një dokument tjetër, P01069, që është kabllogrami nga data 18
25 dhjetor e vitit 1998.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 84

1 PY. Një dokument të cilin e patë më herët, më duket me z.

2 Misetiç.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja 075317.

4 Dhe të kalojmë afër fundit të faqes.

5 PY. Me ç'mbaj mend ju keni parë pikën e parë që ishte më lart

6 në këtë faqe, me z. Misetiç. Ndërsa unë dua të shoh pikën e

7 dytë të kësaj faqeje, e cila flet për faktin, vlerësimin që

8 UÇK-ja "është e ndarë në bazë të vijave brezore, gjeografike,

9 politike..."

10 E mbani mend që e keni thënë këtë gjë, e keni shkruar në

11 atë kohë?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe sa u përket brezave, a është e saktë që z. Krasniqi

14 ishte më i madh në moshë se përfaqësues të tjerë të UÇK-së që

15 keni takuar?

16 PË. Ashtu është, vërtet ashtu është.

17 PY. Dhe ju e dini nga koha juaj në Kosovë që shoqëria

18 shqiptare në fakt i respekton shumë më të moshuarit, ose më të

19 mëdhenjtë në moshë, apo jo?

20 PË. Ashtu është, e saktë.

21 PY. Dhe ju vutë re që kur flisnit me z. Krasniqi, z. Bashota

22 dhe z. Buja, dëgjonin dhe ishte zakonisht z. Krasniqi që

23 fliste, a është e saktë kjo apo jo?

24 PË. Ashtu është, zotëri.

25 PY. Ju ishit një marrëdhënie të mirë edhe me z. Bashota, dhe

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 85

1 keni bërë biseda dhe takime edhe me të kur nuk ka qenë aty z.

2 Krasniqi?

3 PË. Ashtu është, madje mund të shtoj që ne kemi patur një

4 marrëdhënie shumë të mirë edhe me Ramë Bujën.

5 PY. Z. Krasniqi ishte më i madh se si Bashota ashtu edhe

6 Buja, apo jo?

7 PË. Më falni, edhe një herë?

8 PY. Ishte më i madh se të dy zotërinjtë që përmenda.

9 PË. Po, po. Patjetër.

10 PY. Dhe në atë shoqëri është normale që zakonisht më i madhi

11 në moshë flet, apo jo? Ai e mori drejtimin e bisedave dhe

12 ishte më i lartë në trojkë, ishte më i lartë ndoshta më i madh

13 në moshë, dhe ndoshta prandaj fliste, apo jo?

14 PË. Po, po. Por ajo që kuptuam ne ishte që ai ishte kryesori,

15 ishte pjesëtari, anëtari kryesor i trojkës. *Primus inter pares*

16 në rast se mund ta themi në këtë formë.

17 PY. Dhe ai ishte zëdhënësi i UÇK-së në atë kohë, apo jo?

18 PË. Po. Ashtu e kishim kuptuar edhe ne.

19 PY. Dhe një pjesë e përgjegjësive që ka zëdhënësi është që të

20 flasë me delegacionet ndërkombëtare, apo jo?

21 PË. Po, ashtu është.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë, nëse mund të kalojmë tek

23 pika e tretë e këtij dokumenti, dhe që ta shikojmë atë

24 qartësisht në ekran.

25 PY. Ju po bënit një vlerësim në atë kohë që kishte një dallim

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 86

1 në grup ndërmjet atyre që i keni quajtur të moderuarit dhe
2 radikalët brendapërbrenda UÇK-së, është e saktë kjo?

3 PË. Po, është e saktë.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe nëse mund të kalojmë tek faqja
5 075328, në paragrafin 11 të saj, ju lutem.

6 PY. Pra, një nga tiparet e dallimit ndërmjet këtyre dy
7 grupeve ishte që të moderuarit ishin pro pranimit të
8 marrëveshjeve ndërkombëtare, apo jo?

9 PË. Ashtu është.

10 PY. Dhe të moderuarit mbështesnin përpjekjet për të patur një
11 pozicion të vetëm dhe të bashkuar të shqiptarëve, apo jo?

12 PË. Ashtu është.

13 PY. Dhe prandaj ata mbështesnin kontaktet me LDK-në, apo jo?

14 PË. Po, ashtu është.

15 PY. Dhe ju e keni identifikuar z. Krasniqi si një nga këta
16 persona të moderuar, apo jo?

17 PË. Ashtu është.

18 PY. Dhe ju e dinit që ai kishte lidhje me LBD-në, apo jo?

19 PË. E keni fjalën për LDK-në?

20 PY. Jo, LBD-në, që ishte grupi me Rexhep Qosen, Mehmet
21 Hajrizin?

22 PË. Si ishte grupi?

23 PY. Me Rexhep Qosen, Mehmet Hajrizin, LBD-ja. Lëvizja e
24 Bashkuar Demokratike? Po ndoshta ta shikojmë në faqen tjetër
25 të kabllogramit. Ndoshta është më mirë që të lexoni paragrafin

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 87

1 e parë në këtë faqe.

2 PË. Okej.

3 PY. Çka thuhet këtu duket që ka pasur një lidhje mes
4 moderatëve Buja, Krasniqi dhe Bashota, edhe Lëvizja e Bashkuar
5 Demokratike që ishte e Qoses.

6 PË. Po.

7 PY. Bashota pretendon që shumica e UÇK-së, pjesa më e madhe e
8 UÇK-së nuk i kushton shumë politikës, por i dukej interesante
9 programi i LBD-së, edhe më demokrati. A ju kujtohet diçka e
10 tillë?

11 PË. Më falni?

12 PY. Këtë thotë kabllogrami, apo jo? Dhe vijon më tej:

13 "Buja, Krasniqi, Bashota, si edhe komandanti, komandant
14 Leka, i Podujevës, ishin të bashkuar, pra, në atë kohë".

15 Kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Pra, "shihnin me respekt z. Demaçi."

18 PË. Po.

19 PY. Në rregull.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin 14, që është
21 në faqen 075330.

22 PY. Këtu thuhet, këtu flitet pra, për një problematikë që ka
23 pasur Shtabi i Përgjithshëm me LPK-në që pretendohet që të
24 kishte, të merrnin një qëndrim më radikal, pretendohet që i
25 nxiste që të merrnin një qëndrim më radikal, pra, ju kujtohet

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 88

1 kjo?

2 PË. Më lejoni një çast ta lexoj, ju lutem.

3 PY. Patjetër.

4 PË. Në rregull.

5 PY. A ju kujtohet të keni raportuar se LPK-ja nxiste që të
6 merrnin, të mbanin një qëndrim më radikal?

7 PË. Po, besoj se unë dhe fola për këtë dje pasdite. Po, po.
8 Më kujtohet.

9 PY. Ju e dini që z. Krasniqi asnjëherë nuk ka qenë anëtar i
10 LPK-së?

11 PË. Po, ashtu është.

12 PY. Shkojmë më përpara në kohë. Në fakt ju e keni shoqëruar
13 delegacionin e UÇK-së gjatë fluturimit të tyre drejt
14 Rambujesë, më 6 shkurt të 1999, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Po buzëqeshni sepse ata besonin se do ishte më i sigurt
17 fluturimi nëse do ishit dhe ju atje?

18 PË. Kishin frikë se mos i gjuanin forcat ajrore, kundërajrore
19 serbe fluturimin, prandaj.

20 PY. Por duke qenë ju atje, ata ndiheshin më të sigurt?

21 PË. Ata menduan se nuk do të gjuanin avionin në qoftë se do
22 ishte një diplomat amerikan në të.

23 PY. Edhe z. Krasniqi ka qenë në avion si pjesë e
24 delegacionit?

25 PË. Ashtu është.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 89

1 PY. Ju nuk qëndruat gjatë gjithë negociatave më duket, por ju
2 mbajtën të azhurnuar në lidhje me ecurinë e negociatave?

3 PË. Më falni?

4 PY. Ndonëse ju nuk ishit gjatë gjithë kohës me negociatat,
5 juve ju përditësuan në lidhje me zhvillimet.

6 PË. Po. Qëndrova dy ose tri ditë, sepse Departamenti i
7 Shtetit donte që të kthehesha në Kosovë, shumë shpejt biles.
8 Por donin që t'i kisha gjërat nën kontroll, dhe të vijoja të
9 bëja raportimet përkatëse lidhur me zhvillimet në vend. Dhe
10 nuk isha i përfshirë në diskutimet politike që kryheshin në
11 këto tryeza ku po diskutohej Rambujeja. Isha në dijeni,
12 sigurisht, por kisha më shumë një rol negociuesi, ose më
13 saktësisht postieri, do të thoja ndryshe. Çoja letrat nga
14 Chris Hill drejt udhëheqësve të UÇK-së në Kosovë. Bëja rolin e
15 postierit, pra.

16 Ishte Chris dhe Wolfgang Petritsch dhe zyrtarë nga
17 Uashingtoni dhe nga Brukseli personat që ishin më të angazhuar
18 edhe që përfaqësonin, nëse mund ta themi në këtë formë, anën
19 tonë, apo anën tonë me serbët.

20 PY. Prej tyre, e mësuat gjë se si po shkonin negociatat, si
21 po reagonte delegacioni -- i UÇK-së?

22 PË. Jo, burimi im i informacionit ka qenë Florina Krasniqi,
23 që ishte përkthyesja jonë kryesore në këto negociata, dhe
24 dikush në Rambuje, një administrator i kërkoi asaj të
25 qëndronte sepse ishte një përkthyes e shkëlqyer. Fliste

1 shqip, anglisht, frëngjisht. Edhe ajo u pajtua dhe qëndroi.
2 Unë dhe Florina më pas bisedonim, nuk po them çdo mbrëmje, por
3 flisnim rregullisht në telefon, dhe ajo më jepte, më tregonte
4 çfarë kishte ndodhur gjatë ditës në mënyrë që të isha i
5 azhurnuar lidhur me zhvillimet. Në këtë mënyrë kam qenë i
6 informuar.

7 Po theksoj dhe një herë, nuk kemi pasur komunikime të
8 klasifikuara në Prishtinë. Delegacioni nuk mund të na çonte
9 informacione të klasifikuara çdo ditë.

10 PY. Po, a mësuat gjë -- lidhur me rolin e Jakup Krasniqit i
11 cili ishte një rol konstruktiv?

12 PË. Po, ashtu është.

13 PY. Ai u rikthye në Kosovë pas bisedimeve të Rambujesë rreth
14 25 shkurtit të 1999, kështu? 25, 26 shkurt.

15 PË. Besoj se kështu është.

16 PY. Kur u kthye delegacioni në Kosovë, u bënë përpjekje të
17 konsiderueshme diplomatike për të zbuluar çfarë do ndodhte, a
18 do nënshkruhej kjo marrëveshje?

19 PË. Po.

20 PY. Asokohe, Mbretëria e Bashkuar ka qenë pjesë e grupit të
21 kontaktit, dhe ka qenë pjesë e përpjekjeve diplomatike?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe ju besoj e njihni që Sir Brian Donnelly ishte
24 ambasador i asokohe?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 91

1 PY. Dhe David Slinn?

2 PË. Po.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem, mund të kalojmë një çast
4 në seancë private.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
6 seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 92

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 93

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 94

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë te prova

18 materiale P01080, që është një kabllogram që e keni parë dhe

19 më herët, është e 10 marsit 1999. Kalojmë në paragrafin 3, që

20 është në faqen tjetër.

21 PY. Pak më herët ju kam bërë disa pyetje për gjysmën e sipër

22 të këtij paragrafi, mua më intereson gjysma e dytë e këtij

23 paragrafi. Ajo që thuhet në kabllogram është që:

24 "Anëtarë të Drejtorisë Politike si Jakup Krasniqi dhe

25 Ramë Buja janë të arsimuar mirë... e kuptojnë më mirë aspektet

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 95

1 politike se sa pjesa e tjetër e komandantëve ushtarakë.”

2 A është kështu? A është kështu?

3 PË. Kështu e kisha kuptuar unë, ky ishte gjykimi im.

4 PY. Dhe gjykimi juaj në fjalinë e fundit është ky, që

5 Rambujeja në fakt kishte thelluar më tej hendekun mes tyre dhe

6 komandantëve -- ushtarakë?

7 PË. Po.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim paragrafin 4.

9 PY. Në këtë paragraf, ju thoni që komandantët e zonës ishin

10 kryesisht anëtarët që kishin themeluar UÇK-në, që ishin shumë

11 krenarë që kishin marrë armët. Dhe kështu ka qenë, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Por sipas gjykimit tuaj, ka pasur zemërim, një lloj

14 zemërimi kundrejt z. Krasniqi dhe z. Buja, sepse ata nuk ishin

15 anëtarë themelues të UÇK-së edhe në fakt ata kishin qenë

16 anëtarë thjesht të pjesës politike, të establishmentit

17 politik?

18 PË. Këtë përshtypje kishim krijuar ne. Ne po përpigësim t'u

19 shpjegonim në fakt atyre dallimet.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Në të njëjtin kabllogram, shkojmë në
21 faqen 075398. Më poshtë. Fillojmë me paragrafin 6.

22 PY. Dikush të ka dhënë një hierarki, pra hierarkia e UÇK-së

23 dhe për këtë ju i raporton Uashingtonit?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe në fakt Jakup Krasniqi nuk del fare në këtë listë,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 96

1 apo jo?

2 PË. Po.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Më lart në faqe, ju lutem.

4 PY. Ajo që po ndodhte në atë kohë, është kjo. Moderatët e

5 UÇK-së si Krasniqi dhe Buja po përpiqeshin të gjenin një

6 kompromis që të ruanin bashkimin e UÇK-së, apo jo?

7 PË. Po. Unë do shtoja dhe Thaçin në fakt në atë listë, tani

8 në retrospektivë.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta hiqni këtë kabllogram.

11 Faleminderit.

12 PY. Një prej aspekteve që keni trajtuar ju, nga vera e 1998 e

13 në vijim, ishte përpjekja për të krijuar një delegacion të

14 vetëm të unifikuar shqiptar që të merrte pjesë në negociata,

15 kështu?

16 PË. E keni fjalën kur?

17 PY. Po që nga fillimi, që kur shkuat ju në gusht.

18 PË. Nuk mendoj që të jetë bërë ndonjë përpjekje në fillim për

19 të krijuar një delegacion për bisedime. Kjo ka ndodhur vetëm

20 pas, pasi doli Rambujeja në horizont.

21 PY. E dini ju që në korrik të 1998 ishte bërë një propozim

22 për një qeveri të unifikuar, përfshi Mehmet Hajrizin, i cili

23 do të ishte kryeministër?

24 PË. Jo.

25 PY. Në rregull.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 97

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim provën materiale 01072.

2 PY. Për t'ju dhënë kontekstin, kjo është kablllogrami i 26
3 dhjetorit 1998, që e keni parë edhe më përpara.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin 7, në faqen
5 116683.

6 PY. Në këtë kohë, në dhjetor, çështja e një delegacioni të
7 unifikuar ka qenë plan, ka qenë në horizont, kështu?

8 PË. Po. Kjo lidhet me punën e Chris Hill, në fakt, dhe
9 takimet që mbante ai me udhëheqësit e UÇK-së si me presidentin
10 Rugova. Ai nuk na informonte përgjithësisht se çfarë ndodhte,
11 por besoj se ai merrej dhe me udhëheqës të tjerë politikë
12 shqiptarë të Kosovës.

13 PY. Në këto momente Jakup Krasniqi thoshte që UÇK-ja kërkon
14 një kuvend, një parlament të përbashkët që të përfaqësonte të
15 gjitha partitë politike në Kosovë, kështu?

16 PË. Po.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin --

18 PY. Kur të jeni gati na thoni që të kalojmë te faqja tjetër
19 që të përfundoni leximin e paragrafit.

20 PË. Po, ju lutem.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në faqen
22 tjetër.

23 PY. Kjo lidhet me atë që thatë në fillim të pyetjes sime, kur
24 thatë që z. Krasniqi ishte një person që e pëlqente, pëlqente
25 një zgjidhje politike dhe jo dhunën?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 98

1 PË. Po.

2 PY. Dhe në të vërtetë, i ka qortuar Komunitetin Evropian që
3 nuk bënte shumë punë për ta ndihmuar LDK-në apo për të
4 mbështetur Dr. Rugovën?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe prante se UÇK-ja dhe LDK-ja punonin si një
7 organizatë e vetme në shumë pjesë të vendit?

8 PË. Po. Kjo është e vërtetë dhe ne e kemi dëshmuar dhe diçka
9 të tillë.

10 PY. Pra, vërtetimet e tij përputhen me atë që kishit parë edhe
11 ju në terren?

12 PË. Po, atë që kishte parë stafi ynë në terren, po.

13 PY. Dhe ai ka theksuar se ka shumë ish-anëtarë të LDK-së që
14 janë tashmë të UÇK-së, përfshirë vetë atë, z. Buja, dhe z.
15 Bashota, apo jo?

16 PË. Po, ashtu është.

17 PY. Dhe ka thënë se UÇK-ja nuk ka qenë një organizatë
18 joideologjike dhe se mirëpriste pjesëmarrjen e të gjithë
19 shqiptarëve, kështu?

20 PË. Po, ashtu.

21 PY. Dhe kjo pasqyron saktësisht atë që thoshte vërtet z.
22 Krasniqi asokohe, apo jo?

23 PË. Po. Ajo që është shkruar këtu, është një përmbledhje e
24 asaj që na ka thënë z. Krasniqi, është një përshkrim i mirë i
25 qëndrimeve që kishin të moderuarit brenda UÇK-së.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 99

1 PY. A keni qenë në dijeni asokohe që kishte pasur kontakte,
2 kishte kontakte mes Adem Demaçi dhe Dr. Rugovës?

3 PË. Po.

4 PY. Pra, Shtabi i Përgjithshëm po punonte, po përpiquej pra
5 për të kryer ura lidhëse me LDK-në edhe me Dr. Rugovën?

6 PË. Po. Dua të shtoj diçka. Udhëheqja -- kahu i LPK-së i UÇK-
7 së e ka kontaktuar Rugovën dhe në 1997 për të shprehur
8 interesin e tyre për të bashkëpunuar dhe, me sa di unë, Rugova
9 është ai që ka refuzuar këtë.

10 PY. Ku thuhet në kabllogram, është një pjesë në kabllogram në
11 fakt, është një pjesë në kabllogram ku z. Krasniqi thotë që
12 është LDK-ja ajo që ka vështirësi të punojë me UÇK-në dhe nuk
13 është UÇK-ja ajo që ka vështirësi me LDK-në, a përputhet kjo
14 me atë që sapo thatë?

15 PË. Po.

16 PY. Dua të bëj një përmbledhje përpara se të bëjmë pushimin e
17 drekës, dhe mund të themi se i keni thënë dje Prokurorisë se
18 ndonjëherë në bisedat me të, z. Krasniqi ishte shumë kritik
19 ndaj LDK-së. Ju kujtohet që keni thënë diçka të tillë?

20 PË. Z. Krasniqi ka qenë kritik me LDK-në?

21 PY. Po.

22 PË. Po, ashtu është.

23 PY. Ju përpiquej të jepni dhe kontekstin kur folët për
24 diskutimet politike të dokumenteve të z. Hill. Pra, kishte
25 mospërputhje politike mes UÇK-së dhe LDK-së, në çdo sistem

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 100

1 ndodh diçka e tillë, apo jo?

2 PË. Po. Dhe më lejoni ta përsëris dhe një herë. Besoj ajo që
3 kam thënë unë që kjo, nga sa kishim kuptuar ne, mosmarrëveshja
4 kryesore ishte fakti që udhëheqja e UÇK-së ishte e shqetësuar
5 se mos Rugova do të pranonte një marrëveshje të keqe nga
6 ndërkombëtarët dhe një marrëveshje e keqe do të sillte, do të
7 bënte që Kosova të mbetej brenda Serbisë. Por, do të kishte
8 disa aspekte vetëqeverisëse më të kufizuara.

9 Kishte mosmarrëveshje mes udhëheqjes politike të UÇK-së
10 për aspektet politike, por kishte pajtim për një gjë,
11 pavarësia nga Serbia.

12 PY. Atë që shohim në kabllogramet e asaj kohe, tuajat, shohim
13 që z. Krasniqi e pranonte që donte të bashkëpunonte me LDK-në
14 dhe ishte pjesë e grupit të të moderuarve që i bënë thirrje
15 UÇK-së të bashkëpunonte me LDK-në.

16 PË. Kështu e kisha kuptuar unë.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është
18 momenti më i përshtatshëm për të marrë pushimin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
20 tani është ora për pushimin e drekës. Do rifillojmë në orën
21 14.30. Do të dilni nga salla e gjyqit me Asistenten e Sallës.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
24 [Përkthim] Z. Ellis, keni diçka për të shtuar?

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo nuk kam asgjë për të shtuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

2 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

3 --- Seanca rifillon në orën 14.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.

5 Ferdinandusse, e morëm dhe e lexuam mesazhin që na keni

6 dërguar me postë elektronike. Besoj që e keni thënë të

7 gjithëve.

8 Dua t'ju pyes palëve në qoftë se keni ndonjë kundërshtim

9 për sa i takon propozimit për pranimin e transkriptit që z.

10 Ferdinandusse ka përmend në emailin e vet?

11 Nuk duket sikur ka kundërshtime apo jo?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se do të më lejoni një

13 minutë sa për ta konsultuar pak me kolegët e mi.

14 [Mbrojtja këshillohet]

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë i nderuar

16 Kryegjykatës. Nuk ishim të qartë nga mesazhi i dërguar me

17 postë elektronike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Domethënë nuk e kishim të qartë në

20 qoftë se po kërkojnë zëvendësimin e transkriptit apo një

21 transkript shtesë. Këtë nuk e dimë akoma.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.

23 Ferdinandusse, na e shpjegoni pak ju lutem.

24 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Është transkripti i

25 rishikuar.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 102

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
2 nuk është e nevojshme besoj që të zëvendësohet transkripti
3 ekzistues; do ishte më mirë që të kemi vetëm një material,
4 vetëm një dosje në listën e materialeve.

5 Atëherë në rregull do ta konsiderojmë këtë si urdhër të
6 dhënë gojarisht dhe transkripti i rishikuar do të zëvendësojë
7 transkriptin që ekziston tani në listën e provave.

8 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Seancës
9 këshillohen]

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, doja thjesht të
11 pyesja në qoftë se do jetë e mundur që pas një ore të bëjmë
12 një pushim të shkurtër.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do ta
14 bëjmë një pushim të shkurtër.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull z.
17 Byrnes. Tani kemi kohë që të vazhdojmë me pyetjet e mbetura
18 nga z. Ellis edhe me palët e tjera në vijim.

19 Fjala për ju z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim]

21 PY. Mirëdita, z. Byrnes.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
23 paraqesë në ekran një tjetër kabllogram që mban numrin IT-0587
24 6D [Sipas përkthimit]. Shumë faleminderit, znj. Sekretare.

25 PY. Sa për t'ju orientuar, Dëshmitar, bëhet fjalë për një

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 103

1 kabllogram nga 19 prilli 1999. Kjo është data e kabllogramit.
2 Sigurisht që kjo ka qenë gjatë kohës së bombardimit të NATO-s,
3 ndërkohë që ju vetë nuk keni qenë në Kosovë apo jo, Dëshmitar?
4 PË. Po, kemi qenë.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë
6 tek faqja 5 e dokumentit. Tek paragrafi 11. Do i kërkoja
7 Sekretares që të kalojë më poshtë në faqe në mënyrë të tillë
8 që të lexojmë të gjithën paragrafin 11.

9 PY. Së pari, z. Krasniqi ka qenë në Zvicër me datën 17 prill
10 apo jo, Dëshmitar? A keni qenë në dijeni të faktit që z.
11 Krasniqi ka qenë në perëndim gjatë asaj kohe?

12 PË. Nuk më kujtohet.

13 PY. Ai ju ka thirrur nga Zvicra më vonë. Domethënë diku nga
14 data 17 prill apo jo, në fund të ditës, të paktën kështu
15 thuhet në kabllogram?

16 PË. Po.

17 PY. Me ç'këni kuptuar juve, ju e dinit që në atë kohë ai
18 ishte në pozicionin ose në rolin e zëdhënësit apo jo?

19 PË. Po.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë
21 tek paragrafi 12 i njëjtës kabllograme.

22 PY. Këtu thuhet që planet e tij ishin që të shkonte në Romë
23 për takime, por synonte që të kthehej dhe në Tiranë rreth
24 datës 20 prill. Kështu thuhet apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe gjatë kësaj telefonate, gjatë kësaj thirrje ai thotë
2 që z. Krasniqi "zotohet që të ftojë përfaqësues të LDK-së, si
3 dhe politikanë të tjerë nga partitë kryesore në Tiranë për
4 diskutime sapo ju të ktheheshit".

5 A është e reflektuar në mënyrë të saktë kjo në
6 kabllogram, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Juve vetë keni qenë në Tiranë nga fundi i prillit të '99
9 apo jo?

10 PË. Po. Ne u larguam nga Maqedonia dhe shkuan në Tiranë.

11 PY. Pastaj keni qenë në Tiranë edhe në maj të '99 apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Gjatë asaj periudhe edhe z. Krasniqi ka qenë në Tiranë
14 apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe janë zhvilluar takime ndërmjet jush dhe z. Krasniqi
17 në ambasadën amerikane apo jo?

18 PË. Kemi, jemi takuar jozyrtarisht në Hotelin Rogner në
19 Tiranë ku qëndronim dhe kemi ngrënë drekë e kemi pirë kafe
20 aty.

21 PY. Në ato takime ju e keni informuar z. Krasniqi për
22 progresin e bombardimeve të NATO-s. Kjo ka qenë pak a shumë
23 tema e diskutimit apo jo?

24 PË. Nuk mendoj kështu se unë vetë nuk është se dija shumë;
25 nuk kisha shumë informacion sa i takon progresit të

1 bombardimeve të NATO-s. Informacioni që dinim neve ishte
2 kryesisht i bazuar tek kanali televiziv CNN.
3 PY. Përveç z. Krasniqi jeni takuar dhe me përfaqësues të LDK-
4 së në Tiranë apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Është e vërtetë apo jo, që siç thoni juve që ai ka
7 premtuar që të siguronte takime me përfaqësues të LDK-së në
8 Tiranë. Këto takime në Tiranë, në fakt, u realizuan ndërmjet
9 z. Krasniqi dhe këtyre personave apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe një ndër pjesë e këtyre takimeve ishte që të
12 mundoheshin dhe të diskutohej për formimin e qeverisë
13 provizore apo jo?

14 PË. Po, të paktën kaq më kanë thënë mua, se unë nuk është se
15 kam qenë i përfshirë vetë në atë takim.

16 PY. Ju jeni përfshirë në takime me z. Krasniqi dhe me
17 përfaqësues të LDK-së veçmas. Domethënë nuk i keni takuar të
18 dyja palët bashkë apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po. Ne kemi qenë në kontakt.

20 PY. A ju kujtohet që Fehmi Agani, një anëtar shumë i njohur i
21 LDK-së është vrarë nga forcat serbe pak a shumë rreth asaj
22 kohe?

23 PË. Po, patjetër që më kujtohet.

24 PY. Dhe Jakup Krasniqi ka çuar, ka dërguar një telegram
25 publik ku shprehte ngushëllimet për vdekjen e Dr. Aganit apo

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 106

1 jo?

2 PË. Nuk më kujtohet ta kem dëgjuar këtë, por nuk do çuditesha
3 po të ishte e vërtetë kjo.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Do kërkoja të paraqitej në ekran
5 dokumenti SPO00227570. Ndërkohë që paraqitet ky dokument më
6 duhet të kisha kërkuar që të pranohet si provë gjyqësore
7 dokumenti që pamë pak më herët që ishte kablllogrami i prillit
8 të '99.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam mbajtur
10 shënim datën çfarë keni ofruar për provë materiale.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit shumë. Bëhet fjalë për
12 dokumentin IT-05-78 6D016 [Sipas përkthimit].

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 0169 [Sipas
14 përkthimit] pranohet si provë materiale. Ju lutem caktojini
15 një numër identifikimi.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti që sapo
17 përmendët do të marrë numrin e Provës Materiale 4D00036.
18 Klasifikimi është publik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
20 vazhdoni, z. Ellis.

21 Z. ELLIS: [Përkthim]

22 PY. Ndërsa është zhvilluar kjo bisedë ndërmjet meje dhe
23 Trupit Gjyqësor a e patë telegramin që e keni këtu në ekran?

24 PË. Sapo po përfundoj së lexuari telegramin.

25 PY. Tani që e patë telegramin, a ju kujtohet që ta keni parë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 107

1 këtë telegram në atë kohë si deklaratë publike e z. Krasniqi?

2 PË. Jo.

3 PY. Në fund thuhet nga zëdhënësi i QPK-së, Jakup Krasniqi.

4 PË. Po.

5 PY. Ju kështu e keni njohur Jakup Krasniqin, si një person që

6 kishte rolin e zëdhënësit të QPK-së apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Nuk është befasi për juve që z. Krasniqi ka shprehur

9 hidhërim dhe indinjatë për vrasjen e Dr. Aganit apo jo?

10 PË. Jo, nuk është befasi për mua.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem Kryegjykatës, dua që të

12 pranohet si provë gjyqësore ky dokument.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë

14 kundërshtim për pranimin e dokumentit?

15 Megenëse nuk ka kundërshtim dokumenti SPOE00227570

16 pranohet si provë dhe do të marrë një numër prove materiale.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

18 dokumenti SPOE00227570 dhe përkthimi i tij në anglisht do të

19 marrë numrin e Provës Materiale 4D00037 dhe klasifikohet si

20 dokument konfidencial.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik; nuk

23 ka problem.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se

25 nuk ka kundërshtime nga palët.

1 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Do riklasifikohet si dokument publik.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull. Do i lutesha Sekretares
5 të paraqesë në ekran tani dokumentin 019673.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
7 bëjmë një korrigjim.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, a
9 mund të vendosni përbri njëri-tjetrit të dy versionet;
10 versionin në shqip dhe në anglisht të dokumentit që sapo hoqët
11 nga ekрани?

12 Ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen, z. Ellis, por vura re
13 një problem të përkthimit në anglisht të dokumentit tek
14 paragrafi i dytë dhe doja ta sjellja në vëmendjen e të
15 gjithëve. Në versionin në anglisht të dokumentit thuhet "është
16 një akt mizor vrasja e z. të Dr. Rugovës" në vend që të
17 shkruhet "të Dr. Aganit". Kemi një gabim këtu.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Keni absolutisht të drejtë, i
19 nderuar Gjykatës. Mendoj që fillimisht është përkthyer nga
20 ZPS-ja; absolutisht që keni të drejtë. Duhet korrigjuar. Nuk
21 bëhet fjalë për vrasjen e Dr. Rugovës, por bëhet fjalë për
22 vrasjen e Dr. Aganit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar]

25 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Sigurisht që nuk diskutohet

1 që është gabim.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Do të vazhdojmë, mund ta bëjmë këtë
3 gjë, i nderuar Gjykatës. Në rregull. Faleminderit.

4 Do i lutesha Sekretares që të paraqesë dokumentin e
5 radhës që është 019673.

6 PY. Me datën 8 prill në '99, ju keni qenë ende në Maqedoni
7 apo ishit në Tiranë?

8 PË. Nuk e kam ditarin me vete, dhe nuk mund t'ju them po ajo
9 jo, apo ku kam qenë gjatë asaj periudhe.

10 PY. Besoj se e keni dëgjuar për deklaratën publike të bërë
11 nga z. Krasniqi dhe të tjerët lidhur me situatën që
12 mbizotëronte në Kosovë apo jo?

13 PË. Jo gjithmonë. Vetëm herë pas here, ndonjëherë dëgjova
14 informacione të tilla.

15 PY. Për këtë bëhet fjalë për një artikull të BBC-së. Dhe këtu
16 thuhet që Jakup Krasniqi dhe këtu citoj që ai thotë që:

17 "Ne dëshirojmë që të arrijmë në një pikë ku të mbajmë ose
18 të organizojmë zgjedhje të lira".

19 Ndërkohë që drejt fundit të faqes sipas këtij artikulli,
20 jo domethënë e kishim tani në ekran, thuhet më tej që ka
21 "'pesë vende' për qeverinë provizore për partinë e Ibrahim
22 Rugovës".

23 A ju kujtohen, a mund të thoni që a janë këto deklarata
24 që Jakup Krasniqi mund t'i ketë bërë në atë kohë?

25 PË. Nuk e kam parë asnjëherë më përpara këtë deklaratë; nuk

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 110

1 më kujtohet ta ketë thënë diçka të tillë.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duam që të
3 kërkojmë pranimin si provë materiale të këtij artikulli,
4 pavarësisht që dëshmitari thotë që nuk i kujtohet. Pavarësisht
5 kësaj është një artikull i BBC-së.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
7 kundërshtim?

8 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
10 019673 pranohet si provë materiale.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I njëjti dokument që
12 është dokumenti ERN 019673 deri në 74 do të marrë numrin e
13 Provës Materiale 00034 [Sipas përkthimit], me 4D në fillim.
14 Klasifikimi është publik.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares që të
16 paraqesë një pjesë të një videoje që identifikohet si
17 DJK00746. Përkthimi në anglisht është DJK00746-TR-ET.

18 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës
19 këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja më
21 kërkoi mua që t'ju pyesja juve në qoftë se ky klipi i videos
22 mund të transmetohet në publik apo duhet që të transmetohet
23 edhe për palët këtu?

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk ka problem. Mund të
25 transmetohet edhe për publikun.

1 [Luhet videoincizimi]

2 PËRKTHIMI: [Me mbivendosje zëri] "Objektivi i UÇK-së
3 është tërheqja e forcave paraushtarake serbe nga Kosova dhe
4 pas nënshkrimit të marrëveshjes së paqes u kemi bërë thirrje
5 të gjithë luftëtarëve tanë të tregohen të përmbajtur", i bëri
6 të ditur AFP-së zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi.

7 "Krasniqi shprehu kënaqësinë për nënshkrimin e kësaj
8 marrëveshje që përfaqëson perspektiva të reja jo vetëm për
9 shqiptarët e Kosovës, por për të gjithë rajonin".

10 "Marrëveshja duhet të ishte nënshkruar gjatë konferencës
11 së paqes së Rambujesë, pa bombardimet dhe pa masakrat", shtoi
12 ai.

13 "Më pas Krasniqi siguroi se UÇK-ja do të respektojë të
14 drejtat e pakicave etnike të Kosovës sipas normave
15 ndërkombëtare. Civilët serbë të Kosovës i kanë të gjitha
16 garancitë se të drejtat e tyre do të respektohen. Për ata që
17 kanë bashkëpunuar me forcat serbe në masakrat e banorëve të
18 Kosovës - shtoi ai - mendoj se ata duhet të largohen vetë nga
19 krahina. Sidoqoftë, UÇK nuk do të hakmerret".

20 "Më në fund Krasniqi bëri të ditur se organizata e tij
21 është e gatshme të diskutojë me Shtetet e Bashkuara të
22 Amerikës dhe NATO-n për t'u shndërruar në ushtri
23 profesioniste. Kjo ushtri - sipas tij - do të vendoset nën
24 komandën e NATO-s gjatë pranisë së saj në Kosovë. Nuk mendoj
25 se një polici lokale është e mjaftueshme në Kosovë", tha ai

1 duke përfunduar.

2 Z. ELLIS: [Përkthim]

3 PY. Atëherë këto janë zhvillimet me 10 qershor 1999,
4 domethënë, kjo përkon me kohën kur të dy ju dhe z. Krasniqi
5 keni qenë në Tiranë apo jo? Besoj që në përgjigjen që dhatë më
6 herët juve përmendët Hotel Rogner në Tiranë që besoj që e
7 njihni edhe nga çfarë ka këtu poshtë mbrapa shpinës së
8 Krasniqit, pra, që është kjo, Hotel Tirana.

9 Dhe ju, besoj që e dëgjuat që z. Krasniqi e thotë këtu që
10 bën thirrje për luftëtarët që të mos luftojnë dhe që thotë
11 gjithashtu që të drejtat e pakicave etnike do të
12 respektoheshin.

13 PË. Në përgjithësi jam në dijeni të kësaj gjeje. Në takimet
14 tona pak a shumë në të njëjtat linja ka folur ai.

15 PY. Por çështja është që ne e pamë në video që kjo është fakt
16 që z. Krasniqi ka thënë gjëra të tilla apo jo? Jeni dakord
17 besoj me mua. Pajtoheni me mua lidhur me këtë.

18 PË. Po.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
20 pranohet si provë materiale kjo video.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar]

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim. Por kam
24 një pyetje. Nëse nuk gabohem kolegu përmendi një datë për këtë
25 konferencë për shtyp. Ndërkohë që unë vetë nuk është se pashë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 113

1 ndonjë datë në dokument.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që
3 përmendët datën 10 qershor 1999 apo jo?

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, këtë datë përmenda. Është një
5 video që e kemi gjetur *online* dhe data që përkon me këtë
6 konferencë për shtyp është 10 qershori. A keni nevojë që të
7 bëjmë ndonjë përditësim sa i takon videos dhe që lidhet me
8 pyetjen që bëtë juve, pra, për përcaktimin e datës?

9 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Jo, nuk është e nevojshme
10 për aq kohë sa ju e dini që bëhet fjalë për këtë datë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
12 çaktivizuar]

13 Në rregull. Bëjmë kështu: Po japim një numër provizor të
14 provës materiale dhe pastaj ju mund të bëni konstatimin që
15 bëhet fjalë vërtet për këtë datë.

16 Sekretare, caktoji një numër provizor prove.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 videoja DJK00746, versioni në shqip dhe në anglisht do të
19 marrin numrin e përkohshëm të Provës Materiale 4D00039 dhe të
20 dyja videot janë të klasifikuara si publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. ELLIS: [Përkthim]

23 PY. Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar, por shikoj që kam disa
24 pyetje pa trajtuar që lidhen me kabllogramin për të cilin
25 folëm pak më përpara. Janë pyetje që kanë të bëjnë me

1 periudhën e prillit të 1999. Pyetja është kjo, njëra prej
2 pyetjeve: A jeni në dijeni të faktit që z. Krasniqi ka bërë
3 një takim me Sekretaren e Shtetit të asaj kohe, rreth kësaj
4 periudhe?

5 PË. Nuk më kujtohet kjo.

6 PY. A ju kujtohet, po ashtu, që z. Krasniqi ka pasur takime
7 me francezë dhe britanikë po ashtu pak a shumë në atë
8 periudhë?

9 PË. Njësoj. Nuk më kujtohet as për këto takime të z.
10 Krasniqi.

11 PY. Pas përfundimit të konfliktit ju jeni kthyer në Kosovë
12 për një periudhë të shkurtër drejt fundit të korrikut të '99.
13 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 PY. A jeni në dijeni të faktit që Jakup Krasniqi u caktua
16 ministër për rindërtimin dhe zhvillimin në qeverinë e
17 përkohshme të Kosovës?

18 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht këtë gjë; nuk më kujtohet
19 kjo gjë ekzaktësisht. Megjithatë, çfarë më kujtohet është që
20 shumë zyrtarë të lartë të UÇK-së morën poste në qeverinë
21 provizore të Kosovës. Nuk e mbaj mend se në çfarë ministrie u
22 caktua z. Krasniqi.

23 PY. Duke marrë parasysh kushtet e Kosovës në atë kohë,
24 rindërtimi dhe zhvillimi ishte gjëja kryesore ose e vetme që
25 nevojitej apo jo?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 115

1 PË. Po.

2 PY. Veçanërisht në atë kohë ekzistonte shqetësimi që shtëpitë
3 ishin shkatërruar dhe njerëzit duhej që të kishin një strehë
4 ku të fusnin kokën përpara, sesa të vinte dimri apo jo?

5 PË. Po, e vërtetë. Më kujtohet dy raste ku Ndhmës/Sekretari
6 i Departamentit i Çështjeve Evropiane në Departamentin e
7 Shtetit me anë të një vizite me helikopter pa se deri në çfarë
8 mase ishin dëmtimet e shkaktuara dhe më pas Senatori Bob Dole
9 që ishte mik i dashur i Kosovës që po ashtu erdhi në vend dhe
10 pa dëmet e shkaktuara; dëmet ishin të mëdha dhe të gjera.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të
12 paraqesë dokumentin 019662. Dhe nëse mund të kalojmë në pjesën
13 e poshtme të faqes. Po, aty ju lutem.

14 PY. Pamë disa kablllograme përpara pushimit të drekës. Pamë,
15 pra, disa kablllograme përpara pushimit të drekës në të cilin
16 ju përmendët që e dinit lidhjen që kishte Jakup Krasniqi me të
17 tjerë tek LBD-ja. A e dinit që ministri për rindërtimin dhe
18 zhvillimin në atë kohë ishte një post që i përkiste LBD-së?

19 PË. Jo, nuk e dija.

20 PY. Pra, mund të thuhet që z. Krasniqi u emërua nëpërmjet
21 LBD-së me të cilët kishte lidhje dhe jo UÇK-në në atë kohë?

22 PË. Interesante kjo.

23 PY. Po kjo nuk është diçka që ju e kishit kuptuar në atë
24 kohë?

25 PË. Jo, nuk e mbaj mend këtë gjë.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 116

1 PY. Atëherë a mund të kalojmë tek një temë tjetër?

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe kalojmë tek një dokument tjetër
3 me numrin P01074. Shikojmë faqen e parë.

4 PY. Dhe është një kabllogram nga data 4 shkurt e vitit 1999.
5 Pjesa që dëshiroj t'ju tregoj është nga fillimi i faqes
6 075337. Dhe dëshiroj t'ju jap pak kohë që ta lexoni këtë
7 paragraf.

8 Ky është informacion që keni marrë në atë kohë që Shtabi
9 i Përgjithshëm, thuhet që në atë moment kishte një vendndodhje
10 fikse, e shihni këtë në kabllogram?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe kjo është ndryshme nga raportimet e mëparshme ku ju
13 kishit thënë që Shtabi i Përgjithshëm ishte gjatë gjithë kohës
14 në lëvizje?

15 PË. Kështu e kishim kuptuar ne që ishte situata.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë të kalojmë te paragrafi i
17 dytë në këtë faqe.

18 PY. Me ç'duket dikush ju kishte raportuar që kishte domethënë
19 në fakt personat me të cilët ju ishit takuar në UÇK kishin
20 "goxha pajisje, pra, pajisje kompjuterike"?

21 PË. Nuk pashë ndonjë provë për këtë gjë, por më pas në fund
22 të konfliktit dhe pas hyrjes së NATO-s në Kosovë e pashë këtë
23 gjë.

24 PY. Dëshira, natyrisht, ishte që tek ndërkombëtarët të
25 dukeshin dhe të dilnin sikur ishin të organizuar shumë mirë?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 117

1 PË. Po, besoj se kjo ishte.

2 PY. A mund të vijojmë tani me paragrafin e tretë, ju lutem.

3 Ju vetë nuk keni ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë se si merrte
4 vendime Shtabi i Përgjithshëm apo jo?

5 PË. Jo.

6 PY. Po ama këtu thuhet që dikush ju kishte thënë juve që
7 vendimmarrja bëhej në formë demokratike dhe me konsensus apo
8 jo, është e saktë kjo këtu?

9 PË. Po.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vijojmë atëherë me
11 dokumentin gjithashtu me numrin 075344.

12 PY. Do të doja që ju të lexonit atë pjesë ku fillohet me
13 zonën e Nerodimës, pra, fjala e parë është Nerodima.

14 Referenca që i bëhet këtu zonës më të dobët nga aspekti
15 ushtarak dhe gjithashtu me trupat më të keqpajisura, mbi
16 ç'bazë e keni bërë këtë vlerësim?

17 PË. Nga kontaktet që dhe vizitat ose në këtë moment si KVM-ja
18 ashtu edhe ç'kishin mbetur nga KDOM-i, i kishin parë.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë te një dokument
20 tjetër tani, i cili ka numrin P01080.

21 PY. Besoj që shikoni një kabllogram nga data 10 mars 1999. Do
22 t'ju lutesha që të kalojmë te paragrafi 5 i saj, së pari, që
23 është në faqen e tretë të këtij kabllogrami. Po ju jap atëherë
24 pak kohë që ta lexoni.

25 Ndjesë, është fundi i paragrafit numër 4. Gabimi ishte i

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 118

1 imi.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe kalojmë në faqen tjetër për
3 pjesën tjetër të paragrafit numër 4.

4 PY. Vlerësimi juaj në atë moment ishte që ristrukturimi
5 kishte qenë vet i suksesshëm vetëm pjesërisht dhe që në fakt
6 komandantët e zonës vazhdonin që të kishin pavarësinë e tyre
7 operacionale apo jo?

8 PË. E saktë.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Do t'ju lutesha që të kalojmë te
10 paragrafi i 8, në faqen 75400.

11 PY. Këtu flitet për herën e parë kur juve jeni ftuar që të
12 takoheni me Shtabin e Përgjithshëm ne Lladrovc me z. Krasniqi
13 dhe z. Buja apo jo?

14 PË. E saktë.

15 PY. Dhe ajo që patë kur vajtët atje ishin disa zona me mure
16 që tek të cilat arrije pas një kthese në rrugë dhe që punëtorë
17 po vazhdonin punën për të krijuar një vendparkim aty përpara,
18 apo jo?

19 PË. Po.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër, ju
21 lutem.

22 PY. Ju nuk keni parë gjë, për shembull, pajisje komunikimi,
23 antena e të tjerë.

24 PË. Por siç thuhet në kabllogram, jo, me ç'duket.

25 PY. Gjithsesi, kjo ishte 2 kilometra e gjysmë nga një

1 postbllok serb apo jo?

2 PË. Po, po e mbaj mend këtë.

3 PY. Dhe ju jeni person me goxha përvojë ushtarake vetë apo
4 jo?

5 PË. Është e vërtetë.

6 PY. Pra, ju po thoni, keni thënë në deklaratën tuaj në
7 paragrafin 54, nuk na duhet në ekran, po deri në momentin që
8 përfundoi rruga ju nuk patë ndonjë vend që mund të ishte
9 ndonjë seli e vërtetë qendrore, zyrë qendrore?

10 PË. Nuk është se e mbaj mend ta kem thënë, por kjo ka qenë
11 përshtypja që kemi krijuar.

12 PY. Kjo ndërtesë që ju patë në mars të '99 nuk i përngjante
13 ndonjë gjëje që ju mund të prisnit nga ndonjë seli qendrore,
14 nga ndonjë zyrë qendrore, nga, për të ndonjë shtabi?

15 PË. Jo, unë besoj se ka qenë Jakupi, por ndoshta edhe Sokoli,
16 Sokol Bashota që na ka thënë që ky ishte vendi ku ishte shtabi
17 i përgjithshëm, pra, selia qendrore e tyre.

18 PY. Thjesht po kaloj disa shënime që kam bërë.

19 Tani dëshiroj të flas me ju në lidhje me aktivistët e
20 LDK-së si edhe me gazetarët e Tanjugut dhe besoj që edhe dje
21 folët për këtë çështje, dhatë dëshmi dhe madje edhe sot pak.
22 Është e drejtë, apo jo, që dy gazetarët e Tanjugut u mbajtën
23 në mes të tetorit dhe të dy aktivistët e LDK-së në fund të
24 tetorit '98 apo jo?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 120

1 PY. Ka patur periudha kohore gjatë konfliktit kur ju keni
2 pasur ose pak kontakt ose aspak kontakt me Jakup Krasniqin apo
3 jo?

4 PË. Gjatë ndërhyrjes së NATO-s?

5 PY. Jo, gjatë '98. Jo, ka patur periudha kur ju keni qenë në
6 Kosovë, por nuk është se keni pasur fare kontakt, për
7 shembull, me Jakup Krasniqin? A ka pasur periudha të tilla?

8 PË. Me ç'mbaj mend pasi u takuam me trojkën ne kemi qenë në
9 kontakt të rregullt me ta. Nuk e kam ditarin përpara, por --

10 PY. Po mirë, të shikojmë disa gjëra së bashku atëherë.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë te P01067, ju
12 lutem.

13 PY. Dhe këtu shikoni një telegram me datën 3 nëntor 1998.
14 Pra, kjo ka qenë gjatë kohës kur si aktivistët e LDK-së ashtu
15 edhe gazetarët e Tanjugut ishin ndaluar, e saktë?

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë atëherë në faqen me numër
17 075304. Të kalojmë poshtë te paragrafi i fundit në këtë faqe
18 ku flitet për Jakup Krasniqin dhe fillon me këto fjalë: Jakup
19 Krasniqi.

20 PY. Këtu thuhet që kishte kohë që as nuk e kishit takuar as
21 nuk kishit dëgjuar për aktivitetet e tija?

22 PË. Po unë e kam shkruar dhe në fakt i qëndroj asaj që kam
23 shkruar, por nuk mund t'ju them se çfarë do të thotë "për ca
24 kohë". Tashi mbas 25 vitesh nuk mund t'ju them.

25 PY. Po, pas 25 vitesh nuk është se presim që ju ta mbani mend

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 121

1 këtë detaj, por besoj që është e mjaftueshme që ju të kishit
2 nevojë që ta vinit në këtë telegram faktin që kishit kohë që
3 nuk e kishit parë apo jo?

4 PË. E saktë.

5 PY. Ju thatë, më duket ditën e hënë e thatë këtë që u lidhët
6 me trojkën, në fakt, kur morët vesh për ndalimin e tyre?

7 PË. Ma përsërisni pyetjen, ju lutem.

8 PY. Po, për ndalimin e Cen Deskut dhe Jakup Kastratit.

9 PË. Po.

10 PY. Dhe gjithashtu i bie që meqenëse me z. Krasniqi nuk
11 kishit folur për ca kohë nuk është se e keni marrë z. Krasniqi
12 në telefon në atë rast?

13 PË. Jam dakord. Në atë rast do kisha marrë Sokol Bashotën në
14 telefon, thirrjen do ta kisha bërë me të.

15 PY. Sepse më duket se në përgjigjet që ju i dhatë ose z.

16 Misetic ose z. Roberts, më falni, që personi i parë i
17 kontaktit në situata krizash ka qenë gjithmonë Sokol Bashota?

18 PË. Po, ai ishte personi që ne arrinim ta kapnim, pra, të
19 kontaktonim gjithnjë më lehtë.

20 PY. Gjithashtu ju folët edhe me Bardhyl Mahmutin për këtë
21 rast apo jo?

22 PË. Po, fola me të.

23 PY. Dhe ishte z. Mahmuti dhe jo ndokush nga trojka që ju dha
24 shpjegim për ndalimin dhe që tha që ata po trajtoheshin mirë.

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 122

1 PY. A dinit që ndalimi i gazetarëve të Tanjugut ishte dhe një
2 gjë të cilën po e trajtonte Adem Demaçi?

3 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kemi kundërshtim, sepse
4 është shumë e vagullt si pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pajtohem;
6 kundërshtoj. Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e mbaj mend.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë t'ju tregoj transkriptin,
9 procesverbalin 061427-11-TR-ET i Rishikuar.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 bëhet fjalë për materialin P00841_ET.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Me ç'duket është zbardhja ose transkripti i një
14 konference për shtyp me z. Demaçi, kështu që do t'ju lutesha
15 që të kalojmë tek faqja e tretë e këtij materiali. Ju lutem të
16 shikojmë pjesën e poshtme në faqen e tretë. Këtu duket sikur
17 z. Demaçi po u përgjigjet pyetjeve në konferencë për shtyp për
18 gazetarët e Tanjugut. A ju kujtohet kjo, kujtesa, ju kujtohet,
19 ju vjen tani në mend kjo gjë?

20 PË. Nuk mbaj mend ta kem parë ndonjëherë këtë lloj deklarate,
21 kurrë më parë.

22 PY. Në rregull.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë mund ta heqim nga ekрани,
24 faleminderit.

25 PY. Tani besoj se mund ta shikojmë edhe ditarin tuaj nga ajo

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 123

1 periudhë. Dhe ju e keni patur si rutinë që mbanit shënimet

2 takimet më të rëndësishme në ditarin tuaj apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe ajo që ndodhte është që zakonisht ju mbanit shënim

5 emrat e personave të cilët ju takonit dhe ndonjëherë edhe

6 vendin përkatës?

7 PË. Po, zakonisht ashtu ndodhte.

8 PY. Mund të shikojmë me një shembull një faqe, për shembull,

9 faqen P01085 dhe faqja 119783. Ndoshta mund të kalojmë poshtë
10 te fundi i faqes.

11 PY. Për shembull, këtu mund të kemi datën 6 nëntor, për ta

12 marrë si shembull, gjithmonë, ku ju keni thënë: "Në orën

13 12.00, Dragobi". Besoj që është vendndodhja ku ju keni patur

14 disa nga takimet apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Pjesëmarrësit këtu përfshin Christopher Hill, Thaçin,

17 Krasniqin, Bujën dhe Limajn. Këto lexoj unë të paktën apo jo?

18 Sigurisht që kemi dhe faqe të tjera të ditarit, sesa këto

19 që kemi shfaqur këtu në ekran. Mund t'i shikojmë të gjitha po

20 të dëshironi. Megjithatë, nuk shoh ndonjë referencë për Jakup

21 Krasniqin këtu në javën që fillon në fakt, për shembull,

22 fillimin e javës 19 tetor deri ose 26 tetor.

23 PË. Nuk shihni që të kem bërë ndonjë referencë për Jakup

24 Krasniqin?

25 PY. E kisha fjalën për ato dy javët e mëparshme; javën 19

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 124

1 tetor dhe 26 tetor.

2 PË. Pranoj ato që thoni ju në rast se ashtu është dhe në rast
3 se ashtu janë të pasqyruara gjërat në ditar.

4 PY. Dhe kjo do të thotë që në ato data nuk ka patur takime të
5 rëndësishme me të, është e saktë?

6 PË. Po, ashtu duket. Po cilat ishin datat edhe një herë, ju
7 lutem?

8 PY. Në fakt nuk shoh, në ditarin tuaj nuk shoh takime me z.
9 Krasniqi në tetor të vitit 1999.

10 PË. Okej, okej.

11 PY. Dhe ju e konfirmoni, e vërtetoni që në rast se nuk e keni
12 shënuar në ditar atëherë nuk ka pasur takime të rëndësishme me
13 të në ato data apo jo?

14 PË. Me shumë shumë gjasa kjo është e saktë.

15 PY. Pra, ju keni qenë në takim me Ambasadorin Hill dhe z.
16 Krasniqi e të tjerë në datën 6 nëntor apo jo?

17 PË. Po, kam qenë në atë takim.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran
19 dokumentin 019593 deri në 019594. Mund të kalojmë tek fundi i
20 faqes që të lexohet artikulli nga dëshmitari.

21 PY. Keni patur mundësinë ta shihni këtë?

22 PË. Jo, nuk kam patur mundësi ta shoh.

23 PY. Këtu pasqyrohet saktësisht diskutimi që ka qenë diskutim
24 politik për një projekt-marrëveshje përgatitur nga Ambasadori
25 Hill dhe formimin e një organi të besueshëm për shqiptarët e

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 125

1 Kosovës apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe që përfaqësuesit e UÇK-së do ta merrnin këtë projekt-
4 marrëveshje dhe do bënim komente për të apo jo?

5 PË. Është e saktë.

6 PY. Dhe në fakt ashtu bënë; bënë komente apo jo?

7 PË. Po, ashtu bënë.

8 PY. Pavarësisht se u deshën tri javë që të përgjigjeshin dhe
9 pastaj ishte bërë tepër vonë?

10 PË. U desh shumë kohë, e mbaj mend këtë gjë, dhe Chris Hill
11 nuk kishte më durim në ato momente.

12 PY. Po një nga arsyet që ata dëshironin kohë dhe iu desh kjo
13 kohë ishte se po konsultoheshin me një grup personash për të
14 reaguuar siç duhej apo jo?

15 PË. Po, fiks ajo ishte.

16 PY. Po ky nuk ishte takim që të kishte të bënte kryesisht me
17 ndalimin që kishte bërë UÇK-ja apo jo?

18 PË. Jo, jo nuk e mbaj mend, nuk e mbaj mend.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Dëshiroj që artikullin e kësaj
20 gazete ta vendosim si provë materiale.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

22 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet

24 019593 deri në 019594. Sekretarja t'i japi numër.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 126

1 dokumenti do të marrë numrin e Provës Materiale 4D00040 dhe
2 është i klasifikuar si dokument publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e shoh orën dhe
5 ndoshta ky është momenti për të bërë një pushim të shkurtër?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
7 një pushim të shkurtër për 15 minuta.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të përgjigjem unë për
9 pyetjen e fundit që u bë për këtë takim --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

11 DËSHMITARI: [Përkthim] -- dhe nëse ka patur apo jo
12 diskutime në lidhje me dy të rrëmbyerit?

13 Dhe e thënë thjesht fare, mënyra më e lehtë për ta
14 kontrolluar këtë gjë është që të kthehemi në kohë se besoj që
15 në një kabllogram do jetë shkruar diçka. Pra, raportimi që do
16 jetë bërë për diskutimet në këtë takim, pra, nëse ka patur
17 diskutime në lidhje me këta dy të rrëmbyer ato do të kenë qenë
18 të pasqyruara në një kabllogram. Ndërsa unë thjesht tani nuk e
19 mbaj mend se bëhet fjalë për një periudhë 25 vitesh më pas.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Dhe mund të, Dëshmitar mund të shkoni me Asistenten e Seancës.
23 Faleminderit.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 127

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë

2 seanca shtyhet për 15 minuta.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 15.29.

4 --- Seanca rifillon në orën 15.46

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

6 sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

9 z. Byrnes. Do të vazhdojmë me kundërpjetjet nga ana e z.

10 Ellis.

11 Z. Ellis, fjala është për ju.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Dëshmitar, kam edhe disa pyetje në lidhje me gazetarët e

14 Tanjugut edhe veprimtarët e LDK-së.

15 Është e vërtetë kur janë liruar këta persona me 27 nëntor

16 1998 --

17 PË. Po.

18 PY. -- Jakup Krasniqi nuk ka qenë i pranishëm në momentin e

19 lirimit por ka qenë Sokol Bashota dhe ka mbajtur një fjalim të

20 shkurtër. Kështu? Pyetja ime ishte kjo që në momentin e

21 lirimit nuk ka qenë i pranishëm Jakup Krasniqi por Sokol

22 Bashota që ka mbajtur edhe një fjalim të shkurtër?

23 PË. Kështu më kujtohet edhe mua.

24 PY. Pra, Sokol Bashota po e trajtonte këtë çështje bashkë me

25 ju?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 128

1 PË. Po.

2 PY. Për kohën që na ka mbetur sot do të doja të flisnim në
3 vendin ku keni filluar ju, që ka qenë negociatat me ushtarët e
4 ushtrisë jugosllave në janar 1999.

5 A është e vërtetë që kur dëgjuat që ushtarët e ushtrisë
6 jugosllave ishin ndaluar ju kontaktuar z. Krasniqi edhe i
7 kërkuat që të takoheshit me të?

8 PË. Po.

9 PY. Në materialin SPOE00229803, ju diskutuat diçka me
10 Prokurorinë ditën e hënë paradite.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Do të lutesha që të kthehet ky
12 material sërish në ekran.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] për procesverbal është
14 prova materiale P01092.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. ELLIS: [Përkthim]

18 PY. Ju u pajtuat me z. Krasniqi që të takoheshit të nesërmen
19 në mëngjes në Dragobil, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. A e dinit ju aso kohe që z. Krasniqi ishte në zonën e
22 Shalës kur e ka marrë atë thirrje telefonike?

23 PË. Jo, nuk e kam ditur këtë.

24 PY. Sepse ajo që thuhet në këtë dokument është që ai duhej të
25 largohej nga zona e Shalës, ju desh të largohej nga zona e

1 Shalës në orën 10 të mbrëmjes për të shkuar në Divjakë. Dhe se
2 duhet të udhëtonin përmes Mitrovicës që të mbërrinin në
3 Dragobil që të takoheshin me ju. E dinit ju këtë asokohe?

4 PË. Jo.

5 PY. Në fakt ju do ta pranoni që në atë kohë Mitrovica
6 kontrollohej nga forcat serbe?

7 PË. Po, kështu ka qenë.

8 PY. Dhe ata e dinin shumë mirë që z. Krasniqi ishte zëdhënësi
9 i UÇK-së, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe ishte me rrezik për të që të udhëtonte gjatë natës në
12 Mitrovicë në mënyrë që të vinte në takimin me ju të nesërmen
13 paradite?

14 PË. Po.

15 PY. Kjo ka qenë normale ama për marrëdhënien që keni pasur me
16 të. Ai ishte njeri i përgjegjshëm, sidomos në takimet me ju.

17 PË. Po, kështu ka qenë.

18 PY. Takimi në Dragobil besoj se ka qenë takimi i parë nga tre
19 takimet që keni pasur ju lidhur me lirimimin e ushtarëve
20 jugosllavë?

21 PË. Po.

22 PY. I pari në janar 1999 në Dragobil.

23 PË. [Nuk ka përkthim]

24 PY. I dyti më 11 janar 1999 në një fshat që quhet Drenoc në
25 komunën e Malishevës?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 130

1 PË. Po.

2 PY. Dhe i treti, më 13 janar 1999 në Likoc?

3 PË. Likoc, po.

4 PY. Ky është takimi i tretë ku erdhi edhe Ambasadori Walker
5 bashkë me z. Krasniqi, z. Bashota dhe z. Buja?

6 PË. Po.

7 PY. Këto kanë qenë negociata të një profili të lartë dhe të
8 vështira apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. A është e vërtetë që ajo që kishit dëgjuar ju ishte që
11 forcat serbe po kanosnin se do të sulmonin UÇK-në në mënyrë që
12 të realizonin lirimin, qoftë kjo me forcë?

13 PË. Dhe jam i bindur që UÇK-ja e kishte dëgjuar këtë.

14 PY. Në fakt kishin krijuar disa trupa për ta mbështetur këtë
15 kërcënim?

16 PË. Po. MVK-ja kishte raportuar diçka të tillë.

17 PY. A e dini ju që kishte shumë trysni edhe për z. Krasniqi
18 dhe UÇK-në nga komandantët e zonës dhe të tjerët që të mos të
19 binin pre e kësaj trysnisë dhe të mos i lironin ushtarët.

20 PË. Tani po e dëgjoj për herë të parë.

21 PY. Në rregull.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ju tregoj materialin DJK00751.

23 PY. Ky është një artikull i gjatë, në fakt, që është botuar
24 më vonë, por unë dua të shohim DJK00755.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë më poshtë.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 131

1 PY. Ajo që thuhet këtu është, po ju lexoj telegramin nga zona
2 operative Drenicë, ndër të tjera, ku thuhet:

3 "Ne jemi me ju, mos bini pre e presionit të faktorit
4 ndërkombëtar. Drenica do të jetë një mbështetje e fortë."

5 Dhe më pas në fund të faqes thotë:

6 "Zona operative e Dukagjinit në një telegram mbështetës
7 që ja dërgon zonës operative të Shalës -- ju kujtohet që zona
8 e Dukagjinit ishte nën kontrollin e Ramush Haradinajt, po?

9 PË. Po.

10 PY. "Jemi me ju, presioni dhe shantazhi nuk na trembin."

11 Pra ajo që po ndodhte asaj kohe, asokohe tregon që ka
12 pasur presion të madh edhe nga vetë brenda UÇK-së që të mos
13 liroheshin ushtarët ose të paktën të mos liroheshin ushtarët
14 pa marrë diçka në këmbim.

15 PË. Nuk kam qenë në dijeni të kësaj trysnie apo si po
16 shprehej kjo në zonën e Shalës kundrejt Rrahman Ramës.

17 PY. Ndonëse nuk keni qenë në dijeni për këto telegrame
18 konkrete, ju e dini që z. Krasniqi e të tjerë në delegacion
19 ishin në presion të madh gjatë atyre negociatave?

20 PË. Negociatat?

21 PY. Po, po, flas për 9, 11, 13 janarin. Kishte shumë presion
22 ndaj z. Krasniqi dhe të tjerëve në lidhje me këto.

23 PY. Po nuk më ka thënë ndonjëherë që ka qenë në presion. E
24 rrjedhimisht nuk e kam ditur. Ma merrte mendja që ishte në
25 presion sepse sa herë që duhej të merrnim një vendim z.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 132

1 Krasniqi duhet të thërriste dikë në telefon. Nuk na thoshte me
2 kë fliste në telefon, por gjithmonë merrte dikë në telefon.

3 Po ua përsëris edhe një herë, në mënyrë të drejtpërdrejt
4 unë nuk kam qenë në dijeni që ai ka qenë në presion.

5 PY. Ka qenë situatë e tensionuar, apo jo?

6 PË. Ka qenë e tensionuar në Shalë, në Bajgorë, në terren, për
7 shkak të pranisë së forcave ushtarake serbe. Dhe ka qenë
8 sidomos e tensionuar në datën 13 janar në Likoc situata.

9 PY. Në të njëjtën kohë ka pasur disa luftëtarë të UÇK-së që
10 ishin mbajtur të ndaluar dhe ishin nën kontrollin e serbëve

11 PË. Po.

12 PY. Ekzistonte edhe shqetësimi për fatin e këtyre burrave dhe
13 grave, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe në fakt ishte krejt i arsyeshëm ky shqetësim asokohe
16 sepse ishin anëtar të UÇK-së që ishin nën -- të ndaluar nga
17 serbët?

18 PË. Po.

19 PY. Do t'ju tregoj --

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Më falni, para se t'jua tregoj këtë
21 material, përpara se ta heqim dokumentin që është në ekran do
22 të doja që ky artikull gazete të pranohej te provat gjyqësore.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Mua nuk më duhet si artikull
25 gazete ky, megjithatë nuk kam kundërshtime.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 133

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DJK000751
2 pranohet.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një sqarim, i gjithë
4 dokumenti apo vetëm kjo faqe?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,
6 kërkoni vetëm faqen 755 që të pranohet, apo po kërkoni që të
7 pranohet i gjithë dokumenti?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Më jepni pak kohë ta analizoj dhe do
9 t'ju them pak më vonë. Nuk është nevoja që mbase të pranohet i
10 gjithë dokumenti në qoftë se nuk është e nevojshme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Na thoni pak më vonë.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosim tani në ekran
14 K050-8120.

15 PY. NË fakt mbase dhe nuk është nevoja ta shfaqim në ekran.
16 Megjithatë, Dëshmitar, e dini ju, Dëshmitar, që OSBE-ja është
17 lejuar që t'i shihte apo t'i takonte ushtarët e ndaluar?
18 PË. Nuk më kujtohet.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë në këtë rast do të kërkoja
20 që të vendosej faqja 8162 në ekran, e këtij dokumenti që
21 citova më herët. Ju kërkoj falje sepse ju ngatërrova mbase.

22 PY. Po shoh paragrafin ku fillon:

23 "Të dielën ..."

24 I katërta nga sipër.

25 Dëshmitar, asokohe kishit mësuar gjë nga OSBE-ja që

1 ushtarët e ndaluar po trajtoheshin mirë? Ishin në një ndërtesë
2 ku kishte ngrohje, pranë një zone malore në fshati Stari Trg,
3 ku ishte edhe miniera e qymyrgurit?

4 PË. Nuk e kam dëgjuar këtë.

5 PY. Pra, e kuptoni që ka një dallim këtu sepse UÇK-ja e
6 kishte lejuar OSBE-në t'i takonte ushtarët jugosllavë, ndërsa
7 ushtarët e UÇK-së nuk kishin pasur vizitorë?

8 PË. Nuk kam dijeni që paska pasur mundësi MKV-ja t'i takonte
9 ushtarët e ndaluar. As unë -- unë e di që KDOM-i edhe MVK-ja
10 nuk u lejuan në fakt që të takonin ushtarët e UÇK-së, pra
11 ushtarët e Kosovës.

12 PY. Ju aluduat më herët gjatë ditës së sotme për diçka të
13 tillë, megjithatë, një nga problematikat ka qenë që UÇK-ja
14 kërkoi një shkëmbim të njëkohshëm, ndërkohë që pozicioni.
15 Domethënë -- përgjigja ishte "Jo, u refuzua". Dhe kjo nuk
16 është e pazakontë në një konflikt të armatosur që të
17 shkëmbehen të burgosurit.

18 PË. Po, e kemi parë këtë me kalimin e viteve që ndodh.

19 PY. Aktualisht po e shohim që kjo po ndodh në Ukrainë.

20 PË. Po.

21 PY. Duke marrë parasysh mënyrën sesi i kishin trajtuar forcat
22 serbe shqiptarët që i kishin ndaluar në të shkuarën, nuk është
23 e paarsyeshme që të kërkohet një shkëmbim i njehershëm i
24 këtyre të burgosurve?

25 PË. E drejtë është, po as nuk kishte precedentë për këtë.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 135

1 PY. Precedentë për çfarë?

2 PË. Nuk kishte ndodhur ndonjëherë një shkëmbim i njehershëm
3 mes ushtarëve serbë dhe të UÇK-së apo të forcave jugosllave.

4 PY. Por, në fakt dukej sikur forcat serbe po përpiqeshin që
5 të mos realizonin këtë shkëmbim, të paktën për sytë e
6 publikut?

7 PË. Në fakt ana serbe këtë e bëri shumë të qartë.

8 PY. Dhe në fakt ishte UÇK-ja ajo që bëri kompromis edhe u bë
9 një marrëveshje që të liroheshin fillimisht ushtarët
10 jugosllavë dhe 10 ditë më vonë u rikthyen luftëtarët e UÇK-së?

11 PË. Po.

12 PY. Në deklaratën tuaj ju thatë, dhe para një çasti, që gjatë
13 të kësaj kohe përfaqësuesit e UÇK-së ishin në telefon duke
14 biseduar me personat?

15 PË. Nuk ju kuptova.

16 PY. Pra, gjatë këtyre negociatave përfaqësuesit e UÇK-së
17 gjatë të gjithë kohës ishin në telefon?

18 PË. Z. Krasniqi ishte rregullisht në telefon.

19 PY. Do ju tregoj një pjesë të deklaratës suaj.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Është prova materiale P01066, në
21 paragrafin 131. Faqja që vendosëm më herët ishte faqja e
22 duhur. Shkojmë në faqen tjetër. Në kry të kësaj faqe.

23 PY. Dëshmitar, ju thoni kështu:

24 "Jakup Krasniqi në veçanti ishte gjatë të gjithë kohës në
25 telefon. Ai do të ulte telefonin dhe më thoshte se kjo ishte

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 136

1 ajo që ishin të gatshëm të bënin. Unë do të thosha se kjo nuk
2 është e mjaftueshme dhe ai kthehej përsëri në telefon.”

3 Kështu ju kujtohet apo jo?

4 PË. Po, kështu.

5 PY. Dhe vijon në paragrafin 132 dhe thotë:

6 “Përfundimisht, Krasniqi hyri në kuzhinë dhe bisedoi me
7 një person të panjohur me autoritet, në telefon, për rreth 15
8 minuta. Ai më në fund u kthye dhe tha në rregull ne mund ta
9 bëjmë këtë.”

10 Ju kujtohet edhe ju kështu?

11 PË. Po, kështu është.

12 PY. Pra, është e vërtetë që ju nuk e dini se me kë bisedonte
13 në telefon apo nëse fliste me më shumë se një person?

14 PË. Po, kështu.

15 PY. Por, ama asaj kohe ju patët përshtypjen që nuk ishte ai
16 personi që merrte vendimet.

17 PË. Keni absolutisht shumë të drejtë.

18 PË. Dhe një nga arsytet pse këto negociatat zgjatën tri ditë
19 ishte pikërisht për shkak të nevojës që kishte UÇK-ja që të
20 konsultohet?

21 PË. Po.

22 PY. Në Shënimin Përgatitor 2, më duket se keni thënë se z.
23 Krasniqi ka bërë një punë të shkëlqyer në këtë takim? A ju
24 kujtohet edhe ju kështu tani?

25 PË. Po. Donte që të kishte rezultat pozitiv. Donte që të

1 funksiononte ky shkëmbim.

2 PY. Dhe ky ka qenë një shembull i qartë që z. Krasniqi ishte
3 vërtetë një person punëtor dhe bënte të pamundurën që të
4 kishte rezultate?

5 PË. Unë e kam gjithmonë e kam konsideruar pragmatist si
6 person.

7 PY. Ju thatë, z. Krasniqi ju tha se i kishte thënë Rrahman
8 Ramës t'i lironte ushtarët e armatës jugosllave?

9 PË. Po, kështu është.

10 PY. Por ama ju nuk e dëgjuat bisedën e z. Krasniqi dhe z.
11 Rama?

12 PË. Jo, as nuk e dëgjova por edhe sikur ta kisha dëgjuar unë
13 s'do ta kisha kuptuar këtë bisedë.

14 PY. Sigurisht sepse ata kanë folur në shqip.

15 PË. Po, pra.

16 PY. Pra, ju nuk e dini nëse fjala -- mënyra sesi ishte
17 formuluar ky -- si u organizua kjo bisedë a ishte kërkesë, a
18 ishte urdhër, apo çfarë ishte?

19 PË. Saktësisht.

20 PY. Por ama pas thirrjes telefonike ju u kuptuat që z.
21 Krasniqi po përcillte mesazhin që i kishte dhënë z. Rama apo
22 jo?

23 PË. Po, po, ai më tha në fakt që kishte marrë këtë udhëzim.

24 PY. Besoj se në Shënimin Përgatitor, në paragrafin 7 ju keni
25 thënë se Shtabi i Përgjithshëm kishte pak kontroll mbi zonat

1 dhe se Shtabi i Përgjithshëm trajtonte aspektet politike dhe
2 zonat ishin të përgatitura ta pranonin këtë. Kjo është një
3 përmbledhje e drejtë apo jo?

4 PË. Mendoj që në përgjithësi kështu ishte.

5 PY. Dhe kjo nuk ishte asgjë më shumë po ishte një situatë
6 politike që kishte dalë për shkak të situatës me armatën
7 jugosllave. Është një diskutim i nivelit të lartë ku janë
8 përshirë ambasadorët me Shtabin e Përgjithshëm, apo jo?

9 PË. Edhe unë e kam parë këtë si një çështje politike. Pra e
10 nivelit të lartë. Çështje politike e nivelit të lartë.

11 PY. Pra, këto janë çështje që ju mendoni që duhej t'i
12 trajtonte Shtabi i Përgjithshëm?

13 PË. Po.

14 PY. Por, për ndalimin e një personi në një vend të caktuar
15 ishte më shumë një operacion ushtarak dhe kjo kryhej me
16 personat që ishin më poshtë në hierarki?

17 PË. Supozimi im -- më lejoni ta theksoj këtë që ky është një
18 supozim. Ndalimet në terren kanë qenë përgjegjësi ose
19 kryheshin me udhëzim të komandantëve të zonave.

20 PY. Dhe sikurse thatë, nuk ka pasur as precedentë që bëhej ky
21 shkëmbim ushtarësh gjatë luftës në Kosovë apo jo?

22 PË. Unë thashë që në fakt ky rast u bë precedent.

23 PY. Dhe në kohën që ndodhi kjo ishte një situatë unike, apo
24 jo?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 139

1 PY. Keni dhënë gjithashtu lidhur me lirimin e pesë civilëve
2 serbë nga Likovi, mendoj që keni thënë që këta persona janë
3 mbajtur në një vend të veçantë në Likovc, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe ju nuk e dinit fare që këta pesë vetë ishin aty
6 derisa ju tha dikush, apo jo?

7 PY. Keni pasur një bisedë me Prokurorin lidhur me datën e
8 liritimit të këtyre pesë personave. Dhe kam përshtypjen që ju e
9 përcaktuat këtë datë si data 13 janar, në mos gabohem, apo jo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po, po duhet të ketë qenë me datë 13.

12 PY. Sepse ky është rasti që u kujtohet që keni pasur një
13 takim të gjatë në Likoc me z. Krasniqi, me Ambasadorin Walker,
14 e me të tjerët? Kështu?

15 PË. Po, e saktë. Nëse do të më lejoni dua ta shtjelloj pak më
16 tej.

17 PY. Më kujtohet që David Meyer dhe unë patëm një ndjesi
18 euforie që ne dhe nuk e kam fjalën këtu për "ne" personalisht,
19 por e kam fjalën për komunitetin që ne kishim arritur këtë
20 marrëveshjen që të liroheshin të burgosurit. Dhe për këtë
21 arsye, në fakt, MVK-ja po i shoqëronte këta fshatarë që ishin
22 rrëmbyer një ose dy ditë më përpara, po i çonte në shtëpi. Po
23 i shoqëronte në shtëpi. Kështu që për neve kjo ishte një ditë
24 e rëndësishme. Ditë e madhe.

25 PY. Ndërkohë që për z. Krasniqi ishte periudhë dhjetë ditore

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 140

1 kohe për -- gjatë së cilës ai po përpiquej që të gjente dhe të
2 sigurohej a do të ktheheshin apo jo ushtarët e UÇK-së. Apo jo,
3 Dëshmitar?

4 PË. Po, kështu është.

5 PY. Në dëshminë e dhënë të hënën, dhe i referohet këtui për
6 procesverbal transkriptit provizor, në faqen 43, rreshti 4
7 deri në 19, ju thoni si më poshtë:

8 "Mua më kujtohet që më ka thënë Jakup Krasniqi që Sami
9 Lushtaku që ishte komandant i zonës së Drenicës që kishte pesë
10 serbë -- kishte të ndaluar pesë serbë në Mosh."

11 A ju kujtohet kjo apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Mendoj që jam shprehur keq. Kur e lexoj këtë më kujtohet
13 pak më mirë. Si ka ndodhur është kështu që Sokol Bashota është
14 personi që më ka thënë, ma ka thënë këtë gjë. Dhe më pas unë
15 shkova te z. Krasniqi kur kjo ndodhi.

16 PY. A mund të ketë qenë që z. Bashota është marrë me të dyja
17 këto situata, me të dyja këto raste në vend të z. Krasniqi,
18 apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Jo, mua më kujtohet që z. Krasniqi urdhëroi Sami
20 Lushtakun që të lironte të burgosurit dhe t'ja jepte ata MVK-
21 së.

22 PY. Mirë, vazhdojmë më tej.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Dua që të paraqitet në ekran
24 dokumenti DJK00738.

25 PY. Dua t'ju kisha pyetur gjithsesi më përpara Dëshmitar,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 141

1 është problem që të vazhdojmë deri në fund të ditës? Deri në

2 4.30 se kemi edhe 15 minuta për të vijuar?

3 PË. Nuk ka problem. Mund të vazhdojmë deri në fund të ditës.

4 PY. A mund të shikoni dokumentin në ekran?

5 PË. Po, e shikoj dokumentin e shfaqur.

6 PY. Besoj se e lexuat apo jo, Dëshmitar? Sipas *New York Times*

7 bëhet fjalë për 16 janarin. Domethënë, kjo është data kur

8 është raportuar lirimi i ushtarë jugosllavë për të cilët

9 biseduam edhe më herët.

10 Ju kërkoj, e pashë që tundët kokën, por duhet të thoni po

11 ose jo për transkriptin që të pasqyrohet kjo.

12 PË. Po. Ju kërkoj ndjesë unë.

13 PY. Artikulli në kolonën në të djathtë thotë si më poshtë:

14 "Tetë ushtarët e ushtrisë janë kthyer -- i janë kthyer

15 monitoruesve dhe më pas janë kthyer në ushtri. Dhe ata shkuan

16 në garnizone brenda disa orëve. Kështu ka njoftuar z. Walker".

17 Ka ndodhur kështu, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Mendoj se po. Se ata janë kthyer përsëri në garnizone

19 menjëherë pas kësaj.

20 PY. Kjo ka ndodhur me datë 13 janar thoni juve, domethënë,

21 shkëmbimi i luftëtarëve të UÇK-së ka ndodhur diku 10 ditë pas

22 kësaj, që i takon që të ketë qenë rreth datës 23 janar, apo

23 jo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Kërkon që të pranohen në prova gjyqësore

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 142

1 dokumentet që sapo përmendëm

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
3 ka kundërshtime dokumenti DJK00738 do të pranohet si provë
4 materiale.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të marrë
6 numrin e provës materiale 4D00041. Klasifikimi, ja të shikoj
7 një sekondë në sistemin *Lega Workflow* të Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
9 klasifikoni si publik.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] DO i lutesha Sekretares që të
12 paraqesë në ekran dokumentin SITF000385 deri në SITF000385623.
13 PY. Pyetja e parë për ju lidhur me këtë dokument është kjo,
14 Dëshmitar: A pajtoheni me mua që ky është formati që përdorej
15 nga MVK-ja për të raportuar ngjarjet që kishin ndodhur?

16 PË. Jo, nuk mund ta them se siguri këtë gjë.

17 PY. A shikoni në faqen e parë që këtu thuhet që me datë 22
18 janar 1999, në orën 10.30

19 "... MVK-ja është informuar nga MUP-i Prishtinës nga z.
20 Adamovic që pesë civilë serbë janë rrëmbyer sot nga fshati
21 Nevoljanit, që gjendet rreth katër kilometra në perëndim të
22 Vushtrisë."

23 PË. Po, pajtohem.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull. Vazhdojmë me dokumentin
25 tjetër. Faqen tjetër të të njëjtit dokument, në fakt.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 143

1 PY. Ju lutem shiheni dokumentin, hidhini një sy. Do i kërkoja
2 Sekretares ta kalojmë pak më poshtë fletën për ta lexuar
3 dëshmitari. Këtu thuhet që UÇK-ja ishte shprehur që i kanë
4 pesë serbët dhe do t'i lironin ata me kusht që nuk do të
5 kishte më operacione ose veprimtari të MUP-it kundër
6 Vushtrisë. Ndërkohë vijohet më tej. Nuk e di në qoftë se keni
7 mbërritur te kjo fjalia që fillon me RC-2. Çfarë do të thotë?
8 Çfarë është RC-2?

9 RC-2 është qendra rajonale brenda MVK-së apo jo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po. Mendoj se kështu. Të paktën mënyra si e lexoj, kjo
12 është ajo çfarë kuptoj dhe unë me këtë akronim.

13 PY. Kjo sugjeron do të ketë pasur një qendër rajonale të dytë
14 përveç qendrës së parë të MVK-së, apo jo? Dhe i takon që në
15 rastin e ndalimit të pesë serbëve do të ishte kjo qendër e
16 dytë e cila do të ishte në kontakt, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe se ka pasur një hierarki brenda MVK-së dhe që qendrat
19 rajonale ishin në kontakt të vazhdueshëm me homologët e tyre
20 rajonalë të UÇK-së. Kjo është logjika e këtij paragrafi apo
21 jo, Dëshmitar?

22 PË. Nuk e di. Unë mendoj se qendrat rajonale kanë qenë me më
23 shumë tepër burime, kanë pasur shumë herë më tepër burime,
24 personel sesa stacionet e më largëta. Megjithatë, nga ana
25 tjetër stacionet tona, ose zyrat tona më të largëta kishin më

1 shumë kontakt me udhëheqësit lokalë të UÇK-së. Pra në pjesën
2 më të madhe, ose në pjesën dërmuese të rasteve kanë pasur
3 kontakt me komandantët e zonave. Jo në të gjitha rastet ka
4 ndodhur kjo, por gjithsesi në pjesën dërmuese sikurse e
5 thashë.

6 Unë mendoj që MVK-ja e mori situatën në dorë dhe vendosi
7 shumë kontakte. Në shumë raste personeli i KDOM-it ku janë
8 vendosur këto qendra janë transferuar nga qeveria e Shteteve
9 të Bashkuara për MVK-në. Këto qendra do të ishin përgjegjëse
10 për të qenë në kontakt jo vetëm me autoritet lokale serbe, por
11 në qoftë se ishte e mundur që të kishin kontakt të vazhdueshëm
12 edhe me zyrtarë të UÇK-së që operonin në zonë.

13 PY. Atëherë, ajo çfarë duket sikur thuhet këtu, ose
14 përshkruhet këtu, duket sikur --

15 PË. Këtu thuhet që:

16 "RC-2 është në kontakt të vazhdueshëm."

17 PY. Atëherë sa i takon ndalimit të pesë civilëve, për
18 ndalimin e këtyre pesë civilëve serbë, MVK-ja besoj që ka qenë
19 plotësisht e informuar lidhur me këtë apo jo? Dhe sipas kësaj
20 çfarë shkruhet, MVK-ja ka qenë në dijeni dhe ka qenë në
21 kontakt me të dyja palët, apo jo?

22 PË. Po, qartazi kështu.

23 PY. Dhe kur flitet për kontakte me të dyja palët, flitet për
24 kontakte me MUP-in edhe pastaj edhe me pjesën e UÇK-së besoj,
25 apo jo?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 145

1 PË. Po.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do kërkoja që të
3 pranohej si provë materiale ky dokument.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
6 SITF00385623 pranohet si provë materiale dhe do i kërkoja
7 Sekretares t'i caktonte një numër prove.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 dokumenti me ERN SIT00385623 deri në 00385626 do të pranohet
10 dhe do të marrë numrin e provës 4D00042 dhe do të klasifikohet
11 si material konfidencial.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Duke qenë që ky është një material i
14 MVK-së mendoj që duhet të klasifikohet si konfidencial.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Do të ruajë të njëjtën klasifikim, pra do të mbajë
17 klasifikimin konfidencial ky material.

18 Z. ELLIS: [Përkthim]

19 Do i kërkoja Sekretares tani të paraqesë në ekran
20 dokumentin, ose provën materiale P00864. Kalojmë te faqja
21 tjetër, ju lutem. Ju kërkoj ndjesë edhe pak më sipër në faqe.
22 PY. Dëshmitar, këto janë procesverbalet e një takimi.

23 Ndërkohë që në krye të faqes thuhet që është "Organizata për
24 Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, OSBE". Dhe në fillim të
25 procesverbalit thuhet që është 24 janar 1999 dhe bëhet fjalë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 146

1 për një takim të OSBE-së në Likovc.

2 "Dhe tema e takimit ishte lirimi i pesë të burgosurve
3 serbë."

4 A e lexoni këtë pjesën, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Duket se pjesëmarrësit në takim janë nga MVK-ja, janë dy
7 persona që nuk e di që në qoftë se i keni dëgjuar ose i mbani
8 mend që janë z. Ciarka dhe z. Nilsson.

9 PË. Jo.

10 PY. Ndërkohë që sa i takon qendrës rajonale numër 2, ju lutem
11 më thoni edhe një herë atëherë e kisha fjalën për UÇK-në nga
12 UÇK-ja ishte komandanti i zonës së UÇK-së dhe oficeri
13 ndërlidhës në fshatin e Likovcit, apo jo? Të paktën kjo
14 lexohet në raportin që keni përpara, Dëshmitar?

15 PË. Po, është shumë jo specifik në fakt.

16 PY. Ashtu.

17 PË. Likovci ishte -- në Likovc ishte shtabi i zonës Drenicës.
18 Dhe kur flitet për Sali Lushtakun, domethënë pyetja është në
19 qoftë se po merreshin me Sami Lushtakun apo me dikë tjetër që
20 ishte më poshtë zinxhirit të komandës. Kjo nuk është e qartë
21 nga kjo çfarë shkruhet këtu.

22 PY. Jemi në janar, po flasim për janarin e 1999. Komandanti i
23 zonës së Drenicës në janar 1999 ishte Sylejman Selimi, apo jo,
24 Dëshmitar?

25 PË. Nuk e mendoj kështu. Ishte Sami Lushtaku, por ndoshta

1 mund të jetë keqkuptim nga ana ime. Unë mendoj që ka qenë Sami
2 Lushtaku, sipas meje.

3 PY. Megjithatë, a është e drejtë që ju përshkruat një kështu
4 si grusht që ndodhi që çoi në caktimin e Sylejman Selimit që
5 të bëhej komandant në vend të komandantit të mëparshëm, pra
6 gjatë kohës nga Rambujeja dhe Parisi, apo jo?

7 PË. Jo, jo. E keni të saktë këtë, por po kalojmë te pjesa a
8 përgjithshme, tek Sylejman Selimi dhe nuk e di tani në qoftë
9 se dy persona nga MVK-ja kanë biseduar me Sylejman Selimin ose
10 në qoftë se ka qenë dikush tjetër i një niveli më të ulët, një
11 zyrtar tjetër i një rangu më të ulët që ka qenë përgjegjës për
12 fshatin e Likovcit.

13 PY. Në rregull.

14 PY. Ideja që ajo çfarë po lexoj nuk është shumë e qartë
15 domethënë me këtë është folur, domethënë është folur me
16 Sylejman Selimin apo me dikë tjetër më poshtë në hierarki.

17 PY. Në rregull.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Le të shikojmë pak paragrafët 4 dhe
19 5. Do ju jap pak minuta që t'i hidhni një sy që t'i lexoni
20 këta paragrafë.

21 PY. Atëherë, supozimi i komandantit të UÇK-së emrin e të
22 cilit nuk e kemi, ishte që ata i kishin pesë vetët dhe serbët,
23 që ishin në kushte të mira dhe që ishin arrestuar sepse ishin
24 kapur me armatime të rënda. A ju kujtohet e keni dëgjuar një
25 gjë të tillë në atë kohë?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 148

1 PË. Nuk më kujtohet ta kem dëgjuar këtë.

2 PY. Në paragrafin e parafundit në të njëjtën faqe thuhet që
3 komandanti, të paktën duket sikur përfaqësuesve të OSBE-së --
4 përfaqësuesit i ka dërguar tek vendi ku kanë të ndaluar të
5 burgosurit edhe të burgosurit janë shprehur që janë trajtuar
6 mirë. A e shikoni këtë pjesë, këtë paragrafin e parafundit,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Pastaj vijohet me paragrafin e fundit që thuhet që:

10 "Rreth orës 12.00 takimi u ndërpre nga një person që
11 ishte i KDOM-it amerikan. Ai kërkoi që të fliste me një prej
12 komandantëve të UÇK-së."

13 A ju kujtohet kush ka qenë ky personi, burri nga KDOM-i
14 amerikan?

15 PË. Nuk e kam idenë fare. Ka më tepër faqe ky dokument?

16 PY. Po, po, po ka edhe më shumë fletë të tjera.

17 PË. Mbase mund të më bëhet më e qartë po të lexoj
18 informacionin që vjen në faqet pasardhëse. Kjo ka ndodhur në
19 janar, apo jo?

20 PË. Ka ndodhur me 23 janar 1999.

21 PË. KDOM-i ka qenë shumë i shkurtuar. Në numra kemi qenë kam
22 përshtypjen, 40 apo 50 [Sipas përkthimit] oficerë edhe disa
23 automjete dhe patrullimet i kishin shumë të reduktuara, më të
24 shkurtuara në atë kohë.

25 PY. Ju lutem shikoni paragrafin tre nga poshtë në faqe ku

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 149

1 lexon "rreth orës 13.00". Pra, vazhdohet me përshkrimin e
2 ngjarjes edhe komandanti, pavarësisht kush ishte komandanti
3 thuhet në raport që vazhdonte që të premtonte lirimin e
4 personave. A e shikoni këtë pjesën këtu, Dëshmitar? Por
5 dëshironte që t'ju tregonte armët përpara sesa t'i lironte
6 ata. E shikoni këtë pjesën?

7 PË. Po.

8 PY. Të kalojmë te paragrafi i pestë.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë në faqe. Është
10 ky paragrafi që fillon që: "Koha po kalonte dhe asgjë nuk po
11 ndodhte dhe rreth orës 6.00 pasdite armët mbërritën dhe 5 të
12 burgosurit (serbët) u sollën në dhomë".

13 PË. [Nuk ka përkthim]

14 PY. Me sa duket edhe për të demonstruar që ata -- domethënë
15 ideja ishte që t'ju prezantoheshin atyre armët në momentin kur
16 u sollën në dhomë. Kështu apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëhere do i kërkoja Sekretares që
19 të kalojmë pak më sipër në paragraf se më kaloi diçka pa
20 trajtuar.

21 PY. Çfarë ka thënë komandanti i UÇK-së është që "Ata mund t'i
22 kishin liruar që dje, por dëshironte që t'i lironte së bashku
23 me OSBE-në për të treguar që ata janë trajtuar mirë."

24 E shikoni këtë në dokument, Dëshmitar?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 150

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Le të zbresim pak më poshtë në faqe.

2 Ju lutem, Dëshmitar, shikoni tre paragrafët duke filluar nga
3 paragrafi që fillon: "Rreth orës 6 pasdite ..."

4 Lexojeni pak, ju lutem.

5 Ajo çfarë duket sikur ka ngjarë është që me mbërritjen e
6 përfaqësuesve të lartë të OSBE-së përfshirë këtu edhe
7 gjeneralin përkatës edhe Ambasadorin Keller, i takon që nëntë
8 të burgosurit kanë ardhur për t'u liruar. Të paktën kështu
9 thuhet këtu. Domethënë, ishin të gatshëm që të bëhej
10 shkëmbimi?

11 PË. Po.

12 PY. A keni qenë i pranishëm kur është bërë lirimi i tyre?

13 PË. Më kujtohet që kam qenë i pranishëm kur janë liruar nëntë
14 të burgosur të UÇK-së, pra që ishin ushtarë të UÇK-së.

15 Megjithatë, ajo çfarë përshkruhet këtu, me thënë shumë të
16 drejtën, nuk është se më kujton asgjë.

17 PY. Ajo çfarë përshkruhet këtu, Dëshmitar, domethënë, ajo
18 çfarë përshkruhet --

19 PË. Në këtë memo.

20 PY. Ajo çfarë përshkruhet këtu është që UÇK-ja lokale i ka
21 lëvizur pesë të burgosnit serbë aty ku ishin në mënyrë të
22 tillë që të kishin një takim në atë dhomë, domethënë, në atë
23 vend së bashku me përfaqësuesit e OSBE-së.

24 PË. Me sa më kujtohet mua, unë kisha përgjegjësinë për dhjetë
25 ditë radhazi, njëra pas tjetrës që të shkoja, të udhëtoja për

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 151

1 në Nish dhe të vizitoja të burgosurit e UÇK-së dhe të
2 burgosurit e ushtrisë në Nish, në bazën e ushtrisë jugosllave.
3 Dhe këtë gjë e kam bërë. Dhe për këtë arsye UÇK-ja pra, e
4 ndjente dhe kishte marrë disa siguri, disa garanci me fjalë të
5 tjera, që të burgosurit e tyre do të ktheheshin mbrapsht.

6 Dhe sa i takon takimit, mua nuk më kujtohet absolutisht
7 asnjë takim. Lidhur me Ambasadorin Keller e mbaj mend që edhe
8 ai ka qenë aty. Takimi, fjalimet ndoshta kanë ndodhur, por
9 kanë kaluar 25 vite që prej atëherë dhe e kam të tërën të
10 fshirë në kujtesë. Ju kërkoj ndjesë për këtë.

11 PY. Lidhur me këtë dokument ajo çfarë diskutohet këtu në fund
12 fare është që ndërkohë që takimi po vazhdonte dhe u bë lirimi
13 i nëntë të burgosurve të UÇK-së, OSBE-ja, përfaqësuesi i OSBE-
14 së shkoi dhe mori pesë të burgosurit serbë edhe i largoi.

15 PË. Po.

16 PY. Domethënë kjo ndodhi. Ndodhi shkëmbimi i lirimit të
17 ushtarëve të UÇK-së me pesë të burgosurit serbë apo jo?

18 PË. Nuk më kujtohet kjo gjë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, e
20 kemi kaluar kohën.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Në qoftë se më
22 lejoni kam edhe disa të tjera, pak pika të tjera për të
23 trajtuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni
25 nesër. Mund t'i bëni nesër këto pyetje.

1 Dëshmitar, përfunduar për sot. Asistentja do të të
2 nxjerrë nga salla. Faleminderit që ishit me ne sot. Do të
3 vazhdojmë nesër në orën 9.00. Nuk parashikojmë që të na duheni
4 më shumë sesa nesër. Besoj që do të përfundojmë nesër.
5 Faleminderit për gjithë ndihmën dhe mos harroni që s'duhet të
6 flisni me askënd për dëshminë përpara Trupit Gjykses.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Më iku koha. Nuk e
9 kisha mendjen tek ora. Më duket sikur nuk kam më shumë kohë
10 sesa gjysmë ore nesër. Besoj kaq.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, z.
12 Emmerson, besoja që do të fillonit ju sot, por ndodhi kjo gjë.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Thjesht doja t'ju thoja që më
14 duhet më shumë sesa një orë, por jo dy orë. Megjithëse ju
15 kisha njoftuar më përpara që të do më duhej një orë, por duket
16 sikur kam qenë shumë optimist për këtë planifikimin.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të
18 kërkoj të regjistrohen si prova gjyqësore dy dokumente për
19 sot. Janë dokumentet 755 dhe 766 [Sipas përkthimit] DJK.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
21 Sekretare, i keni mbajtur shënim këto? Mirë. Këto dy dokumente
22 pranohen.

23 Faleminderit shumë të gjithëve për vëmendjen dhe për
24 punën. E përfundojmë këtu për sot. Do të shihemi përsëri
25 nesër.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.35

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25